



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 250/5

Tiranë, më 14.6.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 744, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 7.6.2024, është njoftuar vendimi nr. 744, datë 19.3.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 744, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj, aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj, ka përfshirë kontrollin

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezultojnë se:

2.1. ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Artan Hajredinaj*”² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë **.11.2017³, për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Artan *** Hajredinaj*”⁴. Pas kërkesës së Komisionit për përditësim, AKSIK ka përcjellë raportin nr. ***, datë **.1.2024⁵, ku ka referuar se: (i) Për subjektin e rivlerësimit, z. Artan *** Hajredinaj, disponohen të dhëna mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme; (ii) autoritetet verifikuese kanë ndarë informacion të përditësuar me SPAK; (iii) Grupi i punës në AKSIK, thellooi më tej verifikimet duke iu drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të dhëna të reja; (iv) SPAK bën me dije se në emër të z. Hajredinaj nuk rezultojnë të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Në përfundim, ky institucion ka referuar: “*Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Artan *** Hajredinaj, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit*”.

2.3. KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁶ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1. Për vlerësimin e pasurisë: [...] Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit [...].⁷

3.2. Për kontrollin e figurës: [...] Subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].⁸

3.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale: [...] Komisioni çmon se subjekti në disa raste ka treguar mangësi në drejtim të aftësive profesionale, parashikuar nga neni 72 i ligjit nr.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.10.2018.

³ Deklasifikim plotësisht me vendimin nr. ***, datë **.3.2021, të KDZH-së.

⁴ Sqarojmë se ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej tri organeve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ Shtetëror.

⁵ Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ** datë **.1.2024 të KDZH-së.

⁶ Raport i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***/** prot., datë **.7.2018.

⁷ Referohuni në faqen 74, të vendimit të Komisionit.

⁸ Për më tepër referohuni në f. 40, të vendimit të Komisionit.

96/2016, kryesisht në arsyetimin dhe qartësinë e vendimeve, sikurse është evidentuar rast pas rasti në këtë vendim dhe në një rast ka treguar mangësi në drejtim të njohurive ligjore (çështja e trajtuar në paragrafin 50.8 të vendimit), ndërkohë që nuk janë evidentuar mangësi organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, problematika në etikë dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, si dhe aftësive personale dhe angazhimin profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Në një vlerësim tërësor të çështjes, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës, faktin që kanë qenë të shpeshta rastet kur vendimet e subjektit nuk janë ankimuar, qëndrimin pohues dhe reflektues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit në raport me çdo problematikë, Komisioni çmon të konsiderojë si pasaktësi mangësitë në rastet e analizuara, por të tilla që nuk mund të përbëjnë shkak për një vlerësim negativ të aftësive profesionale. Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues për t'u konsideruar i aftë profesionalisht sipas parashikimit të nenit 44, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 59, pika 1, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016. Për një qëndrim sa më objektiv, sa i takon çështjeve të referuara në dy denoncime, konkretisht: (i) çështjes që i përket vendimit nr. **, datë **.4.2020, trajtuar tek paragrafi 50.2.1; (ii) çështjes që i përket vendimit nr. **/**, datë **.3.2022, trajtuar tek paragrafi 50.15, Komisioni vlerësoi transferimin e tyre pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore [...].⁹

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa "a", dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 744/2024, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

⁹ Për më tepër referohuni në f. 73-74, të vendimit të Komisionit.

10. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 744, datë 19.3.2024, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A - Kontrolli i pasurisë

11. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

12. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

13. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave vjetore periodike dhe asaj Vetting, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në datën *.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, janë:

14. Pasuria nr. 1: Apartament banimi me sip. 113,1 m², me adresë Tiranë

14.1. Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi, me sip. 113,1 m², kati *, adresa rruga “**** **”, ***, Tiranë, kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** Kol, dt. *.10.2006, blerë në shumën 45.000 euro dhe 30.000 euro shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore, nga të ardhurat si noter në vitet 2001-2007, shitje toke bujqësore, kredi pranë *** Bank. Vlera: 75.000 euro. Pjesa takuese: 50%.*

14.2. Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI, datë *.3.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë sipërmarrje nr. ***/***, datë *.10.2006, për blerje apartamenti me sip. 113,1 m² në z. k. *** Tiranë, vlera 70.000 euro. Deri në *.12.2007 paguar 65.000 euro. Të ardhura nga kredia për blerje apartamenti marrë nga Banka *** *.10.2007 me kontratën ***/***, shumë 40.000 euro; të ardhura nga aktiviteti privat noter; të ardhura nga shitjet e pasurive nr. 1/2 dhe 1/1 me sip. totale 19.000 m² të ndodhura në B.C. Shuma e detyrimit 5.000 euro. Paguar deri më *.12.2007 shuma 942 euro. Shuma e detyrimit të mbetur 39.000 euro¹⁰.*

14.3. Në aktin dorëzuar në ILDKPKI në datën *.10.2014, format deklaratë “Para fillimit të detyrës¹¹”, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrje për blerje apartamenti me sipërfaqe 113,1 m² në shumën prej 70.000 euro, me burim: të ardhura si noter dhe të ardhura nga shitja e tokës bujqësore, paguar shuma prej 25.000 euro dhe si detyrim të mbetur ndaj firmës “****” sh.p.k. ka deklaruar shumën prej 45.000 euro.

14.4. Në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar se i ka paguar ndërtuesit gjithsej shumën prej 40.000 euro, duke vënë në dispozicion dhe mandatet e arkëtimit nga shoqëria¹². Subjekti ka deklaruar gjithashtu se ndërtuesi ndërpreu punimet, pasi apartamenti ishte në fazën e karabinasë dhe për këtë arsye ai vetë, subjekti, aplikoi për kredi

¹⁰ Duket se e ka për detyrimin e mbetur të kredisë.

¹¹ Subjekti i rivlerësimit është emëruar si gjyqtar në datën *.3.2007, por nuk rezulton që të ketë plotësuar deklaratën para fillimit të detyrës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. I thirrur në ILDKPKI në tetor 2014, subjekti i rivlerësimit, pasi ka konstatuar mungesën e kësaj deklarate, ka dorëzuar së bashku me aktet sipas procesverbalit të ILDKPKI-së dhe formatin deklaratë para fillimit të detyrës me datë dorëzimi *.10.2014.

¹² Konkretisht në dt. *.10.2006 shumën 20.000 euro, në dt. *.3.2007 shumën 10.000 euro, në dt. *.8.2007 shumën 8.000 euro, për të cilat ka paraqitur dhe mandatpagesat, ndërsa për shumën 2.000 euro deklaroi se nuk mund të gjejë dokument.

për rikonstrukcion apartamenti dhe të gjitha punimet janë kryer prej tij. Duke qenë se punimet i kreu ai, shuma e mbetur prej 5.000 euro e palikuiduar nuk iu kërkua më nga ndërtuesi, fakt i cili do të reflektohet në kontratën përfundimtare kur të regjistrohet apartamenti¹³.

14.5. Nga aktet në dosje lidhur me origjinën e kësaj pasurie, ka rezultuar kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2006, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj ka porositur një apartamentit tek shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., me sip. 113,1 m², ndodhur në Komunën ***, në vlerën totale prej 45.000 euro. Sipas kontratës, mënyra e pagesës është përcaktuar: kësti i parë prej 15.000 euro do të paguhet më datë **.10.2006; kësti i dytë prej 25.000 euro do të paguhet më datë **.11.2006; kësti i tretë prej 5.000 euro do të paguhet me përfundimin dhe marrjen e çelësave në dorë.

14.6. *** Bank me shkresë nr. **-*** prot., datë **.9.2023, ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e subjektit të rivlerësimit: (i) kontratë kredie nr. ***/*** datë **.10.2007, nënshkruar ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në cilësinë e kredimarrësve dhe Bankës *** *** në rolin e kredidhënësit, për shumën 35.000 euro me qëllim blerjen/rikonstrukcion e një apartamenti me adresë Komuna ***, Tiranë. Në këtë kontratë përcaktohet se pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 30.000 euro. Dorëzanës në këtë kredi janë motra dhe kunati i subjektit (***. dhe ***.***), përfaqësuar nga vetë subjekti me prokurën nr. ***/*** datë **.8.2007; (ii) protokollin e kredisë konsumatore për subjektin e rivlerësimit për përfitimin e shumës 5.000 euro me qëllim: *blerje pajisje shtëpie*; (iii) transaksionin e transferimit të shumës prej 34.510 euro nga llogaria e subjektit të rivlerësimit tek llogaria e shitësit “****” sh.p.k., datë **.10.2007.

14.7. Në përfundim të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se:

14.7.1. subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit për shkak të balancës negative prej - 1.815.767 lekë para fillimit të detyrës dhe - 2.481.400 lekë gjatë detyrës;

14.7.2. subjekti ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat e pasurisë ndër vite, në deklaratën Vetting, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ, në lidhje me çmimin e apartamentit dhe burimin e të ardhurave;

14.7.3. ka dyshime të arsyeshme për blerje/shitje fiktive të dy pasurive nr. 1/1 dhe nr. 1/2, të ardhurat e të cilave janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit objekt verifikimi.

14.8. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit dhe ka paraqitur akte në funksion të pretendimeve të tij¹⁴.

14.8.1. Komisioni, në përfundim lidhur me këtë pasuri, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se: *[...] Sa i takon paqartësive dhe pasaktësive të evidentuara në mënyrën e deklaramit të çmimit të pasurisë së blerë, në analizë të parashtrimeve të subjektit në raport me të gjitha deklaramit në deklaratat e paraqitura pranë ILDKPKI-së dhe ato gjatë hetimit, në përfundim të procesit vlerësohet se pasaktësitë dhe mospërputhjet e evidentuara nuk janë kryer me ndonjë qëllim të caktuar dhe si të tilla nuk kanë ndonjë peshë specifike... Në këto kushte, Komisioni nuk vlerëson me ndonjë peshë specifike faktin nëse punimet për përfundimin e punimeve janë kryer nga subjekti apo nga shoqëria ndërtimore, duke i dhënë peshë faktit se kredia prej 35.000 euro është përdorur për përfundimin e punimeve dhe mobilim. Sa i takon dyshimeve të ngritura për blerje/shitje fiktive të dy pasurive nr. 1/1 dhe 1/2. ... Në përfundim të procesit, përtej dyshimeve të ngritura gjatë hetimit administrativ, bazuar në një analizë ligjore e logjike të fakteve të sipërpërmendura, Komisioni vlerësoi se nuk mund të konkludohet për veprime fiktive të blerjes dhe shitjes së pasurive nr. 1/1 dhe 1/2 në periudhën kur subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues dhe as në detyrën e gjuqtarit dhe se çmimi i blerjes/shitjes pasqyruar në kontratat përkatëse*

¹³ ASHK, Drejtoria vendore Tirana Jug me shkresë nr. ***/* prot., datë **.3.2021 dhe ASHK, Drejtoria vendore Tirana Veri me shkresë nr. ***/* prot., datë **.3.2021 konfirmojnë se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

¹⁴ Referohuni prapësimeve të subjektit lidhur me kriterin e pasurisë dhe akteve në funksion të këtyre prapësimeve.

është shprehje e vullnetit të lirë të palëve bazuar në rrethanat dhe periudhën kur janë kryer veprimet juridike. Për pasojë, të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre të deklaruara nga subjekti në mënyrë koherente, si në deklaratat e interesave privatë, ashtu dhe në deklaratën Vetting si burim për blerjen e apartamentit, duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kohën e përfutimit të tyre, duke i përfshirë ato në analizën financiare të rishikuar. Sa i përket kundërshtimit të balancës negative prej - 1.815.767 lekësh për periudhën para detyrës dhe - 2.481.400 lekë gjatë detyrës, pretendimet e subjektit vlerësohen të bazuara, për sa kohë analiza afektohej më së shumti nga të ardhurat nga shitja e pasurive nr. 1/1 dhe 1/2 të cilat u konsideruan të ligjshme. Për pasojë, balanca negative e periudhës para detyrës bie, ndërsa sa i takon balancës negative pas fillimit të detyrës, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditeti cash në DPFD në datën **.3.2008, nuk mund të konkludohet se të ardhurat nga shitja e pasurive nr. 1/1 dhe 1/2 në tetor të vitit 2006, nuk kanë shërbyer si burim për pagesën e kësteve prej 10.000 euro, 6 ditë pas fillimit të detyrës, në datën **.3.2007 dhe 10.000 euro 4 muaj më pas, në datën **.8.2007. Veç sa më sipër, për një vlerësim sa më objektiv Komisioni mban në konsideratë se periudha e pagesave për pasurinë objekt vlerësimi është një periudhë tranzicioni e kalimit nga ushtrimi i aktivitetit si noter në detyrën e gjyqtarit dhe pretendimet e subjektit në lidhje me paqartësinë në deklarime në atë periudhë vlerësohen të besueshme. Në këto kushte, duke konsideruar si të ardhura të ligjshme nga periudhat e kaluara shumë prej 2.077.302 lekësh (ku bëjnë pjesë edhe të ardhurat nga shitja e dy tokave vreshta), e cila rezultoi si mundësi kursimi deri më **.3.2007, këto të ardhura janë vlerësuar se kanë shërbyer për pagesën e kësteve prej 2.481.400 lekësh të paguara pas fillimit të detyrës dhe në analizën e rishikuar financiare për pagesën e kësteve, balanca negative ulet në vlerën 414.098 lekë. Sa i takon shpenzimeve për mobilim, referuar deklaramentit të subjektit në deklaratën Vetting ku ka deklaruar se shuma 30.000 euro është shpenzuar për mobilim dhe punime ndërtimore me burim kredinë e marrë nga *** Bank, i cili është në koherencë të plotë me deklaramentet në përgjigje të pyetësorit standard dhe me të gjitha faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, në përfundim të procesit Komisioni e vlerëson tërësisht të besueshëm pretendimin se shuma 13.000 euro për arredim/mobilim është pjesë e shumës 34.150 euro përfutuar me kredi, e cila është shpenzuar nga ana e subjektit për përfundimin e punimeve dhe mobilim e apartamentit. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se subjekti ka kundërshtuar bindshëm barrën e provës në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi apartament banimi me sip. 113.1 m², në ***, Tiranë, duke kaluar kështu testin e rivlerësimit për këtë pasuri [...].

14.9. Komisioneri Publik, për sa më sipër, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me saktësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit mbi vlerën e blerjes së kësaj pasurie, si dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të përdorura për blerjen e saj, për sa më poshtë arsyetuar:

14.9.1. Fillimisht, lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse edhe pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni dhe deklarimet e tij nuk duken se gjejnë mbështetje në raport me rrethanat e konstatuara, në kushtet kur:

14.9.1.1. Nga verifikimi i akteve në dosje kanë rezultuar të deklaruara vlera të ndryshme nga subjekti, respektivisht: (i) 75.000 euro deklaruar në Deklaratën “Vetting”; (ii) 65.000 euro në DV-2008; (iii) 40.000 euro paguar tek shoqëria ndërtuese, referuar përgjigjeve të pyetësorit standard; (iv) 34.510 euro paguar nëpërmjet transaksionit bankar të datës **.10.2007; (v) 65.000 euro referuar kontratës së kredisë bankare, në të cilën në nenin 1 të saj specifikohet se *Banka bie dakord t'i japë kredimarrësit kredi në monedhën euro në shumën 35.000 euro, për rikonstruksion/blerje dhe investimi i kredimarrësve është në shumën 30.000 euro.*

14.9.1.2. Ndërkohë, nga aktet e vëna në dispozicion të hetimit, rezulton se është paguar për llogari të shitësit shuma prej 38.000 euro, depozituar në cash sipas tri mandateve të arkëtimit depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit (çka së bashku me shumën e transferuar në llogarinë bankare të firmës ndërtuese, prej 34.510 euro, do të çonte në shumën totale prej 72.510 euro).

14.9.1.3. Kontradiktore vlerësohen dhe deklarimet e subjektit mbi destinacionin e shumës së marrë kredi nga Banka *** ***, pasi sikundër ka rezultuar, shuma prej 34.510 euro është kaluar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. me përshkrimin: *pagesë për blerje apartamenti Artan Hajredinaj* dhe në datën **.10.2007, kjo shumë është tërhequr në *cash* nga administratori i shoqërisë ***, ***, sipas konfirmimit të *** Bank me shkresë nr. *** prot., datë **.11.2023. Ndërkohë, vetë subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se shuma e përfituar nga kredia bankare është tërhequr dhe poseduar në *cash* nga ai vetë dhe përdorur për rikonstruksion/mobilim. Pretendimi i subjektit, vetëm në prapësime, se kjo shumë i është dhënë *cash* nga administratori ***.***., mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur në akte provuese. Në kuadër të pasaktësive si më sipër, të paprovuara mbetën dhe pretendimet e subjektit mbi koston e mobilimit dhe mbulimin me burime të ligjshme të tyre¹⁵.

14.9.1.4. Sa më sipër trajtuar, deklarimet kontradiktore të subjektit mbi vlerën e blerjes dhe destinacionin e kredisë bankare, në vlerësimin e *Komisionerit Publik* konsiderohen si përpjekje të tij për të paraqitur ndryshe këtë situatë dhe tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit, e cila duket se nuk përkon me qëllimin e procesit të rivlerësimit për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Problematikat e konstatuara më sipër duhen trajtuar nga Kolegji së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

14.9.2. Për sa i përket burimeve të ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, *Komisioneri Publik* ndan vlerësim të ndryshëm nga ai i Komisionit lidhur me burimin e deklaruar: *të ardhura nga shitja e pasurive nr. 1/1 dhe nr. 1/2*, Bajram Curri, Tropojë, në vlerën 12.392.800 lekë, për sa më poshtë trajtuar:

14.9.2.1. Sikundër ka referuar dhe Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, nga aktet në dosje ka rezultuar se dy pasuritë me numra respektivisht nr. 1/1 dhe nr. 1/2 të llojit *vresht*, rezultojnë të jenë shitur me çmime ndjeshëm më të larta së çmimi i blerjes së tyre (pasuritë shitur për vlerën 12.392.800 lekë (në total) nga 1.500.000 lekë (në total) që janë blerë vetëm 4 muaj përpara shitjes).

14.9.2.2. *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi diferencën e ndjeshme të çmimeve të shitjes dhe blerjes së këtyre pasurive për një periudhë të shkurtër kohore dhe shpjegimet e subjektit duken jo bindëse, për sa kohë kur edhe Bashkia Tropojë me shkresë nr. ***/* datë **.2.2024, i ka kthyer përgjigje subjektit se: “*Në lidhje me çmimin dhe vlerën e tokës në periudhën 2005-2009, nuk kemi informacion*”. Akti i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, raporti i vlerësimit i shkurtit 2024, vlerësohet se është hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit dhe për këtë arsye merret me rezervë në këtë proces, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji në raste të ngjashme.

14.9.2.3. Gjatë hetimit administrativ nuk u evidentua ndonjë transaksion bankar apo gjurmë tjetër e të ardhurave të përfituara nga shitja, nisur dhe nga vlera e lartë e çmimit të shitjes së tyre, dhe rrjedhimisht mbetet i dyshimtë fakti i likuidimit të çmimit të shitjes *në dorë* për një vlerë të tillë (referuar përcaktimeve në kontratë), apo dhe mënyra si këto fonde, në vlerë të konsiderueshme, janë administruar dhe ruajtur nga subjekti.

14.9.2.4. Për më tepër, nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, z. Hajredinaj, në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, kishte ekspozim në kredi marrë pranë FFZM, me interes të lartë (15%), të cilin duket se e ka shlyer vetëm në shtator 2007 (rreth një vit pas përfitimit të të ardhurave nga këto shitje).

14.9.2.5. Gjithashtu, nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti ka vazhduar të aplikojë dhe të përfitojë kredi bankare, si për apartamentin në Tiranë, ashtu dhe për qëllime të tjera (kredi për

¹⁵ Në përfundim, subjekti ka pretenduar se kostoja e mobilimit, 13.000 euro, është pjesë e kredisë bankare në shumën 35.000 euro, pretendim të cilin Komisioni në përfundim e ka vlerësuar të besueshëm, ndërkohë subjekti në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar mobilim në vlerën 600.000 lekë, në D-Vetting deklaroi vlerën 30.000 euro për mobilim dhe punime ndërtimore, nga aktet në dosje ka rezultuar dhe përfitimi i një kredie nga Banka *** *** në shumën 5.000 euro, e cila gjithashtu deklarohet nga subjekti se është marrë me qëllim mobilimin e këtij apartamenti.

mobilim apo overdrafte bankare)¹⁶, çka tregon për pamundësi financiare të tij për të mbuluar investimet/shpenzimet me të ardhura të tij.

14.9.2.6. Gjatë hetimit administrativ e paprovuar mbeti dhe mundësia financiare e blerësit A. H., pasi bazuar dhe në aktet e depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit, konfirmohet ekzistenca e aktivitetit ekonomik të blerësit, por nuk është administruar asnjë e dhënë mbi fitimet/të ardhurat e realizuara nga ky i fundit.

14.9.3. Komisioneri Publik vlerëson të pabazuar dhe konkluzionin e Komisionit mbi evidentimin e mundësisë së kursimit (në shumën prej 2.077.302 lekësh që vjen dhe si rezultat i përfshirjes së të ardhurave nga shitja e dy tokave të llojit “vresht”) deri më datë **3.2007, mundësi e cila është vlerësuar se ka shërbyer për pagesën e kësteve të paguara pas fillimit të detyrës, arsyetim ky, që ka bërë të ulet ndjeshëm pamjaftueshmëria financiare e konstatuar.

14.9.3.1. Sikundër ka rezultuar, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar deklaratë përpara fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së (që do të duhej të depozitohet brenda muajit prill të vitit 2007). Ndërkohë, në deklaratën format “*Para fillimit të detyrës*”, dorëzuar ILDKPKI në datën **3.2008 dhe konsideruar si deklarata e parë e subjektit, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar posedim të kursimeve në *cash* me burim pikërisht nga këto transaksione shitjeje.

14.9.3.2. Subjekti nuk ka deklaruar posedim të kursimeve *cash* me burim nga shitja e dy pasurive si më sipër, as në deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI në tetor 2014, ku është përpjekur të qartësojë/sistemojë mungesën e deklaramit para fillimit të detyrës në vitin 2007, duke bërë të pabesueshëm këtë prezumim të Komisionit.

14.9.4. Në përfundim për këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi vlerën dhe burimet e ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e pasurisë *apartment banimi* me sipërfaqe 113,1 m², ndodhur në Tiranë, duke mos arritur nivel të besueshëm, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës.

15. Të ardhura nga shitja e pasurive “Njësi shërbimi”, ndodhur në Bajram Curri

15.1. Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: (i) *Të ardhura nga Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë **6.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. */**_***/, Z.K.***, B. Curri, Tropojë. Shuma 120.855 euro;* (ii) *Të ardhura nga Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë **6.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. */**_***/, Z.K.***, B. Curri, Tropojë. Shuma 10.678 euro;* (iii) *Të ardhura nga Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë **6.2016, për pasurinë e paluajtshme nr. */**/*, Z.K.***, B. Curri, Tropojë. Shuma 6.500 euro.*

15.2. Në deklaratën e parë të pasurisë, dorëzuar në ILDKPKI në datën **3.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pasuria nr.*/**+*-***, zona kadastrale ****, sip. 105.8 m², lagjja “***”, Bajram Curri. Lloji i pasurisë njësi tregtare, blerë në datën **7.2005. Kësaj pasurie i është bërë shtesë dhe ngritje kati në bazë të lejes së ndërtimit nr.* datë **12.2006. Sipërfaqe pas ndërtimit 222 m² + kat. Shuma e shpenzuar 2.259.351 lekë. Nga të ardhurat nga vëllezërit në Angli dhe Zvicër. Vlera 1.600.000 lekë, pjesa takuese 50%.*

15.3. Lidhur me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurive të mësipërme, të tjetërsuara në vitin 2016 nga aktet në dosje, rezulton se¹⁷:

¹⁶ Përveç kontratës për blerje/rikonstruksion apartamenti në Tiranë kanë rezultuar dhe: Kontratë kredie bankare me ***, në emër të bashkëshortes datë **1.2007, për shumën 800.000 lekë; kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse pranë ***, në emër të Artan Hajredinaj, datë **1.2008, për shumën 80.000 lekë; kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse pranë ***, në emër të Artan Hajredinaj, datë **2.2010 për shumën 210.000 lekë; kontratë overdrafti pranë ***, në emër të Artan Hajredinaj, datë **7.2011, për shumën 220.000 lekë etj.

¹⁷ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së ASHK Tropojë dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

15.3.1. Me kontratë shitblerje nr. ***/**, datë **.7.2005, Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit ***/** pasurinë nr. */**+**-**, lloji *njësi tregtare*, me sip. 105,8 m², me çmim 1.600.000 lekë¹⁸.

15.3.2. Me vendim nr. *, datë **.01.2006, të KRRT Kukës, është miratuar studimi urbanistik dhe kondicionet urbane për sheshin e ndërtimit me sip. 260 m², me destinacion *shtesë objekti*, duke cituar faktin se ka dokument pronësie vetëm për 105,8 m². Me vendimin nr. *, datë **.12.2006, KRRT Kukës ka vendosur të miratojë planimetrinë e sheshit me sip. 260 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 222 m², me destinacion objekti "*Shtesë objekti dhe ngritje kati*", me adresë lagjja "****", Bashkia Bajram Curri.

15.3.3. Me kontratë shitblerje nr. ***/**, datë **.9.2006, Artan Hajredinaj i ka blerë shtetasit ***/** një truall të lirë me sip. 150 m², me nr. pasurie */**/*, ndodhur në Bajram Curri, në vlerën 200.000 lekë.

15.3.4. Me kontratë shitblerje nr. ***/**, datë **.9.2006, Artan Hajredinaj së bashku me shtetasit ***/**, ***/** dhe ***/**, kanë blerë nga shtetasi ***/** pasurinë nr. */**/* e lloji *truall* nën objekt me sip. 140,7 m², në vlerën 300.000 lekë.

15.3.5. Me *deklaratë për heqje dorë nga pasuria e paluajtshme truall nën objekt*, nr. ***/**, datë **.11.2006, bashkëpronarët ***/**, ***/** dhe ***/**, deklarojnë se heqin dorë nga pasuria */**/* e llojit truall nën objekt me sip. 140,7 m² në favor të bashkëpronarit Artan Hajredinaj, i cili do t'ju kthejë shumën 300.000 lekë bashkëpronarëve të tjerë.

15.3.6. Sipas vërtetimit hipotekor datë **.1.2009, figuron në pronësi të Artan Hajredinaj pasuria nr. */**-**, njësi me sip. 392,59 m², para gjykatës Tropojë (shtesë dhe ngritje kati), me komentin: *shkresa nr.*** datë **.12.08 nga K.R.T Bashkia B.C., leje shfrytëzimi **, dt **.11.2008, vendimi nr. * datë **.12.2006, leje ndërtimi K.Q. Kukës ***, ****.

15.3.7. Në vitin 2014 në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur leje shfrytëzimi, në përmbajtje të së cilës pasqyrohet se procesverbali i kolaudimit është mbajtur më datë **.9.2008.

15.3.8. ZVRPP/ASHK Tropojë kanë konfirmuar se pasuria nr. */**+** (njësi ekzistuese), më vonë është bashkuar me pasurinë nr. */**-** me sip. 392,59 m² (objekt i ndërtuar mbi këtë të vjetrin), duke shpjeguar dhe bashkimet e ndarjet me trojet nr. */**/* dhe nr. */**/* (blerë me kontratat e sipërpërmendura), duke formuar kështu njësitë nr. */**-*** me sip. 98,49 m² dhe nr. */**-*** me sip. 399,5 m². Në vitin 2016 njësia nr. */**-*** është ndarë në tri pasuri: (1) nr. */**-***/*, (2) nr. */**-***/*, të cilat janë dhuruar¹⁹ dhe pasuri (3) nr. */**-***/* e cila së bashku me pasurinë nr. */**-***, janë shitur²⁰.

15.4. Lidhur me pasuritë e dhuruara, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se njësitë me nr. */**-***/* dhe nr. */**-***/*, ia ka dhuruar shtetasit ***/**, pasi nga ky i fundit janë mbuluar dhe shpenzimet e ndërtimit, sipas lejes nr. *, datë **.12.2006, duke shpjeguar se që nga momenti i fillimit të ndërtimit dhe deri në momentin e dhurimit, nuk ka bërë asnjë shpenzim dhe se shtetasi ***/** që nga fillimi i ka disponuar dhe poseduar këto pasuri.

15.5. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën **.10.2014, subjekti i rivlerësimit i pyetur mbi diferencat e sipërfaqeve të njësive që konfirmon ZVRPP Tropojë, në total 497,9 m² me atë të deklaruar në PFD 2007 (njësi tregtare 105,8 m² + shtesë dhe ngritje kati me sip. 222 m²), ka deklaruar: *në total është e vërtetë që kemi 497,9 m²*. Gjithashtu ka deklaruar se ndërtimi ka mbaruar në vitin 2008.

15.6. Komisioni, në lidhje me vlerën e ndërtimit të shtesës së lokalit ekzistues dhe kateve sipër, pasuri nr. */**-**, si dhe periudhat e ndërtimit, ka konstatuar se në DPDF datë **.3.2008,

¹⁸ Në datë **.07.2005 Artan Hajredinaj ka bërë kërkesë për shtesë objekti e cila me vendim KRRT Kukës, pa datë, është miratuar për sipërfaqe sheshi 260 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 222 m². Formulari i lidhjes së objektit me infrastrukture e inxhinierike mban datën **.7.2005, i miratuar nga institucionet përkatëse.

¹⁹ Me akt dhurimi nr. ***/** datë **.6.2016, dhuruar shtetasit ***/**.

²⁰ Sipas kontratave deklaruar nga subjekti në Deklaratën "Vetting".

subjekti ka deklaruar vlerën e investimit prej 2.259.351 lekë me burim nga të ardhurat e vëllezërve nga Anglia dhe Zvicra, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar dhe një vlerë prej 600.000 lekë, investim të kryer nga shtetasi *** ***, vlerë, e cila nuk vërtetohet me ndonjë akt shkresor. Komisioni nga hetimi, nuk ka administruar procesverbal kolaudimi që të vërtetojë periudhën dhe vlerën e investimit, ndërkohë që ka administruar lejen e shfrytëzimit më datë **.11.2008, në përmbajtje të së cilës shkruhet se procesverbali i kolaudimit është mbajtur më datë **.9.2008.

15.7. Në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor (akt kolaudimi) që të provojë vlerën faktike të investimit dhe kohën e saktë të kryerjes së punimeve, Komisioni ka kryer përlllogaritjet e kostove të ndërtimit për përfundimin e shtesës së lokalit ekzistues dhe kateve sipër sipas lejes së ndërtimit të datës **.12.2006, duke konsideruar: (i) sipërfaqen e shtesës prej 392,59 m² të ndërtuar sipas vërtetimit hipotekor të vitit 2009; (ii) periudhën e kryerjes së punimeve nga data **.12.2006 (kur është lëshuar leja e ndërtimit) deri në datën **.9.2008 (referuar datës kur është mbajtur procesverbali i kolaudimit sipas lejes së shfrytëzimit nr. **, datë **.11.2008); (iii) koston mesatare të ndërtimit për qytetin e Bajram Currit për vitet 2006 – 2008 sipas EKB-së, duke rezultuar vlerë e llogaritur prej 13.219.017 lekësh.

15.8. Në vijim Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e blerjes së njësisë ekzistuese prej 105,8 m² në datën **.7.2005, në vlerën 1.600.000 lekë, nga ku ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme. Sa i takon investimit në shtesën e njësisë ekzistuese, pasuria nr. */**-* me kosto të përlllogaritur në vlerën prej 13.219.017 lekësh, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar këtë investim, për shkak se në periudhën para detyrës **.12.2006 – **.3.2007 ka rezultuar balancë negative në vlerën - 1.755.756 lekë dhe në periudhën pas detyrës, **.3.2007 – **.9.2008, ka rezultuar balancë negative në vlerën - 11.380.978 lekë.

15.9. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, pasi duket se: (i) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet për një balancë negative në shumën 1.755.756 lekë në periudhën **.12.2006 – **.3.2007 (para detyrës) dhe 11.380.978 lekë në periudhën **.3.2007 – **.9.2008 (gjatë detyrës); (ii) subjekti nuk i ka deklaruar njësitë në DV-2009, si dhe ka bërë deklarime të pasakta dhe të paplota ndër vite dhe gjatë procesit, në lidhje me sipërfaqet e njësisve dhe burimin e krijimit; (iii) mbetet e paqartë arsyeja e dhurimit të njësisve nr. */**_**/* dhe nr. */**_**/* shtetasit *** *** në vitin 2016, për më tepër 7 vite pas regjistrimit të tyre në ZVRPP, duke ngritur dyshime për dhurime fiktive, pasi të gjitha deklaratimet e subjektit sa i takon shkaqeve të dhurimeve, janë në nivel deklarativ dhe nuk justifikojnë dhurimin e pasurive.

15.10. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare për ndërtimin e shtesës, ndër të tjera, ka kundërshtuar përlllogaritjet e Komisionit: (i) në lidhje me periudhën e investimeve, si dhe (ii) vlerën/koston e përlllogaritur të punimeve. Sa i takon periudhës së investimeve të konsideruar nga Komisioni **.12.2006 – **.9.2008, subjekti ka pretenduar se kjo periudhë nuk është e saktë, për faktin se punimet për shtesat kanë nisur dhe kanë përfunduar në periudhën 2006 – 2007, brenda afatit të lejes së ndërtimit, datë **.2.2007. Sa i takon vlerës së përlllogaritur të investimeve, subjekti kundërshton mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni bazuar në koston sipas EKB-së, duke pretenduar se vlera e investimit është sipas preventivit datë **.7.2005 në shumën 2.259.351 lekë²¹.

15.10.1. Në lidhje me konstatimin e Komisionit mbi pasaktësitë në deklaratimet e njësisve apo sipërfaqeve të tyre, subjekti ndër të tjera ka deklaruar se është e vërtetë që në DPDFD-në e dorëzuar në datën **.3.2008 ka deklaruar vetëm blerjen e njësisë ekzistuese nr. */**+*_**, duke lënë pa deklaruar blerjen e pasurive nr. */**/* truall me sip. 150 m² dhe nr. */**/* truall

²¹ Subjekti për të provuar pretendimet e tij ka paraqitur së bashku me parashtrimet dhe një akt ekspertimi me datë **.2.2024 nga ekspert inxhinier *** ***.

me sip. 140,7 m², por në këtë deklaratë ka dhënë shpjegime në lidhje me ngritjen e lokalit shtesë sipas lejes së ndërtimit me sipërfaqe ndërtimi 222 m² + kat, i cili ndodhet mbi trojet e padeklaruara.

15.10.2. Në lidhje me paqartësitë mbi burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës, subjekti ka deklaruar se si burim për investimin shtesë përfunduar në datën **.2.2007, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurive nr. */* dhe */*. Ai pretendon se është krejtësisht e pamundur të bëhet ndarja dhe përcaktimi i saktë çfarë shume u mor nga prurjet e vëllezërve dhe çfarë shume u përdor nga shitja e pasurive si më sipër, apo çfarë shume u përdor nga kredia e marrë në atë periudhë pranë FAF-së²², për të cilën deklaroi se i ka dalë nga kujtesa dhe se kjo kredi e marrë dhe disbursuar në datën **.8.2006 ka si objekt “Rikonstruksion të një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij”, e cila sipas tij është marrë për ndërtimin e këtij objekti në pritje të lejes së ndërtimit.

15.10.3. Në lidhje me pasuritë e dhuruara shtetasit *** ***, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se, që nga momenti i fillimit të ndërtimit dhe deri në momentin e dhurimit, nuk ka bërë asnjë shpenzim dhe se ky shtetas që nga fillimi i ka disponuar, poseduar apo vjelë frytet mbi këto pasuri. Fakti që ky dhurim u realizua 7 vite pas regjistrimit, ka të bëjë vetëm me neglizhencën e të dyja palëve në kushtet e një marrëdhënieje të plotë mirëbesimi.

15.11. Komisioni, në përfundim, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit në lidhje me këtë çështje janë të besueshme dhe dokumentet e administruara arrijnë një nivel provueshmërie të tillë, që Komisioni të krijojë bindjen se punimet janë kryer brenda afatit të lejes së ndërtimit, pra **.12.2006 – **.2.2007 dhe jo brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni në përfundim të hetimit **.12.2006 – **.9.2008... Komisioni bazuar në një analizë logjike e harmonike të të gjitha fakteve dhe provave arsyetuar si më sipër, në analizën e rishikuar financiare vlerësoi të konsiderojë si kohë investimi periudhën e parashikuar në lejen e ndërtimit **.12.2006 – **.2.2007 dhe vlerën e investimit prej 6.720.969 lekësh, që është 44.1% më pak se vlera e përllorë sipas çmimeve të EKB-së për periudhën përkatëse. Sa i takon pasaktësitë në deklaratime, pretendimet e subjektit vlerësohen bindëse dhe ndonjë pasaktësi apo paqartësi në deklaratimet e viteve 2008 – 2009 ka ndodhur si pasojë e veprimeve shumëdimensionale që subjekti ka kryer në një hark kohor të shkurtër. Nga ana tjetër, mbahet në konsideratë edhe qëndrimi i subjektit, i cili pranon pasaktësitë në deklaratime, duke dhënë në çdo rast argumentet përse kanë ndodhur dhe se janë të paqëllimta, për shkak se pavarësisht kësaj ai ka treguar kujdes për të depozituar të gjitha dokumentet. Sa i takon pasaktësitë në deklaratimet në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, nga ana e Komisionit vlerësohet se, në kushtet kur investimi ka filluar dhe përfunduar përpara fillimit të detyrës nga subjekti dhe ai nuk ka pasur detyrimin e deklaratimeve, justifikohen paqartësitë apo mospërputhjet në deklaratime. Nga analiza financiare e rishikuar pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, rezulton se ai ka justifikuar investimet me të ardhura të ligjshme, në këto kushte edhe pasaktësitë janë pa ndonjë pasojë. Në lidhje me pasuritë e dhuruara shtetasit ***. ***, për të cilat gjatë hetimit administrativ u ngritën dyshime për dhurime fiktive, vlerësohet se argumentet dhe provat e paraqitura nga subjekti janë në koherencë të plotë me deklaratimet e tij dhe se dhurimi i pasurive nuk është një akt i beftë, por është rrjedhojë e disa rrethanave pararendëse.

Si konkluzion, në përfundim të procesit, duke u nisur nga specifika e rastit, elementet objektive dhe subjektive të arsyetuara më lart, vijueshmëria e fakteve dhe rrethanave që lidhin subjektin dhe shtetasin ***. ***, i cili nuk ka qenë një shtetas i panjohur për të, Komisioni nuk gjeti ndonjë arsye të qëllim të subjektit për të kryer dhurime fiktive të të dyja pasurive, duke i konsideruar këto dhurime si shprehje të lirë të vullnetit të palëve në vijim të marrëdhënieve/rrethanave të pranuar prej tyre përpara lidhjes së kontratave të dhurimit. Për rrjedhojë, sqarimet e subjektit në lidhje me këtë çështje vlerësohen si bindëse. Sa i përket të

²² Sikundër do të trajtohet në vijim në çështje të tjera.

*ardhurave nga shitja e pasurive nr. */**_***/* dhe nr. */**_***, ato janë konsideruar të ligjshme nga Komisioni, pasi plotësojnë kriteret e nenit D, të pikës 3, të aneksit të Kushtetutës. [...].*

15.12. *Komisioneri Publik*, lidhur me pasuritë “Njësi Shërbimi”, ndodhur në Bajram Curri, shitur dhe dhuruar prej subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës së Komisionit, për sa më poshtë trajtuar:

15.12.1. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat periodike vjetore lidhur me këto pasuri, pasi në deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI në datën **.3.2008, deklaroi vetëm pasurinë nr.*/**+*-** me sipërfaqe 105,8 m,² të blerë në vlerën 1.600.000 lekë dhe shtesë 222 m² + kat, për të cilën deklaroi shpenzime në shumën 2.259.351 lekë, dhe nuk rezultoi të ketë deklaruar blerjen e pasurive të tjera, që më pas janë bashkuar dhe mbi të cilat është investuar kjo pasuri. Gjithashtu nuk rezultoi që në deklaratat e pasurisë në vijim të ketë deklaruar ndryshimet lidhur me këtë pasuri.

15.12.2. Sipërfaqja e ndërtimit e deklaruar nga subjekti në deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI në datën **.3.2008 (222 m²+ kat), nuk përputhet me sipërfaqen faktike të pasurisë shtesë (prej 392,59 m²), e cila është dukshëm më e madhe se sipërfaqja e deklaruar nga subjekti në deklarimin e tij të parë në vitin 2008.

15.12.3. Vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e shpenzuar për kryerjen e investimit të sipërcituar, prej 2.259.351 lekësh ose rreth 5.755 lekë/m²²³, rezultoi ndjeshëm më e ulët se kostoja e ndërtimit në qytetin e Tropojës për vitin 2007, e cila sipas EKB-së llogaritet në vlerën 26.734 lekë/m². Referuar sipërfaqes së konsiderueshme të shtuar dhe faktit se investimi është kryer nga një shoqëri ndërtuese, bazuar dhe në metodologjinë dhe standardin e KPA-së, vlerësohet se mbetet i pambështetur konkluzioni i Komisionit mbi uljen e kostos së investimit nga 13.219.017 lekë në 6.720.969 lekë dhe përlllogaritja e vlerës së investimit duhet kryer sipas çmimeve referuese të EKB-së për sipërfaqe ndërtimi, sikurse është llogaritur nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ.

15.12.4. Gjithashtu vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore edhe lidhur me kohën e kryerjes së këtij investimi, pasi në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se investimi ka përfunduar në vitin 2008, ndërsa gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se investimi është përfunduar deri në shkurt të vitit 2007. Ky pretendim i marrë në konsideratë dhe nga Komisioni, bie ndesh me aktin e kolaudimit, i cili referon vitin 2008²⁴. Komisioneri Publik sjell në vëmendje dhe faktin se leja e ndërtimit lidhur me këtë objekt mban datën **.12.2006, çka bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit se ndërtimi është kryer deri në shkurt 2007, nisur dhe nga sipërfaqja e konsiderueshme e ndërtimit.

15.12.5. Kontradiktore vlerësohen edhe deklarimet e subjektit lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive, pasi në deklaratën e parë të pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI në datën **.3.2008, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: të ardhurat nga vëllezërit në Angli dhe Zvicër, ndërsa gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se si burim për investimin në shtesë, i cili ka përfunduar në datën **.2.2007, kanë shërbyer të ardhurat e shitjes së pasurive nr. */* dhe */*, dhe kredia e marrë në atë periudhë pranë FAF-së, për të cilën deklaroi se i ka dalë nga kujtesa²⁵.

15.12.6. Lidhur me dhurimet e kryera në favor të shtetasit *** dhe kostot e pretenduara si të mbuluara prej tij, Komisioneri Publik i vlerëson të paprovuara deklarimet e subjektit, për sa kohë që ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në Deklaratën “Vetting”

²³ Vlera e deklaruar nga subjekti 2.259.351 lekë / 392.59 m² që përfaqëson sipërfaqen e ndërtuar sipas vërtetimit hipotekor datë **.1.2009, rezultoi kosto 5.754 lekë/m².

²⁴ Datën **.9.2008, referuar datës kur është mbajtur procesverbali i kolaudimit sipas lejes së shfrytëzimit nr. **, datë **.11.2008.

²⁵ Subjekti ka pretenduar se është e pamundur të bëhet ndarja dhe përcaktimi i saktë çfarë shume u mor nga prurjet e vëllezërve dhe çfarë shume u përdor nga shitja e vreshtave apo nga kredia pranë ***.

dhe në asnjë prej deklaratave të pasurisë ndër vite dorëzuar në ILDKPKI, investimin e pretenduar të kryer nga ky shtetas, si dhe nuk ka provuar as gjatë hetimit administrativ me akte të kohës, pretendimin se investimi në këto njësi tregtare të dhuruara, është kryer nga shtetasi *** ***. Për më tepër rezulton se me aktin “*deklaratë për heqje dorë...*” nr. ***/***, datë **.11.2006, bashkëpronarët e pasurisë truell me sipërfaqe 140,7 m², një nga të cilët është dhe shtetasi *** ***, kanë hequr dorë nga bashkëpronësia kundrejt vlerës 300.000 lekë, që iu është paguar nga subjekti i rivlerësimit.

15.13. Në përfundim, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me këto pasuri dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me vlerën dhe kohën e investimit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë “Njësi shërbimi”, duke u ndodhur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

15.13.1. Gjithashtu vlerësohet se subjekti ka mbajtur qëndrime kontradiktore për të dhënat e deklaruara rreth pasurive të mësipërme, në kundërshtim me detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 32 të ligjit nr. 84/2016, çka bën të pamundur kontrollin e plotë lidhur me këto pasuri.

15.13.2. Nga aktet e administruara rezulton se të ardhurat nga shitja e pasurive nr. */**_***, dhe nr. */**_***/*, kanë shërbyer kryesisht si burim për krijimin e llogarisë bankare në vlerën 80.055 USD në *** Bank, të deklaruar në deklaratën “Vetting”, si dhe për dhënien e dy huave shtetasve *** ***, në shumën 30.000 euro dhe ***.***. në shumën 19.000 USD. Pamundësia e kontrollit të plotë lidhur me pasurinë “Njësi shërbimi”, të ardhurat nga shitja e të cilave (në vitin 2016) kanë shërbyer si burim krijimi për llogarinë bankare pranë *** Bank dhe huat e dhëna në vitin 2016, afekton dhe ligjshmërinë e krijimit të këtyre të fundit.

15.14. Përveç sa më sipër, në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja për periudhat **.7.2014 – **.6.2016, sipas kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2014 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.11.2014, në shumën: 720.000 lekë, të ardhura të realizuara nga dhënia me qira e pasurisë nr. */**_***, “Njësi shërbimi” ndodhur në Bajram Curri. Sa i takon shlyerjes së detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton se detyrimet tatimore lidhur me to, janë paguar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2021, duke vënë në diskutim në këtë mënyrë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit.

15.15. Gjatë hetimit administrativ, është administruar edhe një kontratë tjetër qiraje, nr. ***/***, datë **.7.2013, për të njëjtin objekt, me qiramarrës shtetasin *** ***, me afat 1-vjeçar dhe me çmim qiraje 20.000 lekë/muaj. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo kontratë nuk ka pasur efekte juridike, pasi pala qiramarrëse nuk realizoi investimin dhe nuk kreu aktivitet në këtë pasuri. Kjo marrëdhënie qiraje nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore respektive dhe as në atë “Vetting”, duke mbetur kështu e paqartë dhe në nivel deklarativ vërtetësia e deklarimeve të subjektit lidhur me realizimin e këtyre të ardhurave.

15.16. *Komisioni Publik* vlerëson se problematikat e konstatuara më sipër duhen trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

16. Apartament banimi me sipërfaqe 80,6 m², ndodhur në Bajram Curri

16.1. Në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar se nga data **.3.2007 deri në datën **.3.2017, ka banuar në apartamentin nr. *, ndërtesa nr. **, hyrja nr. *, rruga “**** **”, Bajram Curri²⁶. Subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë nga shtetasja *** *** (***), e motra e tij, me kontratë nr. *** kol., datë **.5.2005. Pak kohë pas

²⁶ Subjekti ka deklaruar se kjo adresë është e njëjta me adresën lagjja “**** **”, sot lagjja “****”, pallati **, shkalla *, kati *, apartament *, qyteti Bajram Curri, Tropojë.

blerjes, subjekti ka rënë dakord me të motrën që ta blinte ai këtë apartament, duke i dhënë shumën prej 500.000 lekë rreth fundit të vitit 2005. Subjekti deklaroi se ky apartament ka qenë *de facto* në pronësi të tij, megjithëse nuk ishte bërë kontratë për kalimin e pronësisë. Me kontratë dhurimi nr. *** rep., dhe nr. ** kol., datë **.01.2018, ky apartament ka kaluar në pronësi të subjektit.

16.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *kjo pasuri është likuiduar prej meje në emër të motrës sime që në vitin 2005 me pagimin e shumës 500.000 lekë. Ndaj në kushtet kur unë e kisha paguar këtë shumë, dhe jo motra ime, u vlerësua që kalimi i pronësisë të bëhej nëpërmjet Kontratës së dhurimit që u lidh mes nesh*²⁷.

16.2.1. Lidhur e këtë pasuri në dosje të Komisionit janë administruar: (i) Kontratë shitblerje datë **.5.2005²⁸, me anë të së cilës znj. *** ** i ka blerë bashkëpronarëve ***, ***, dhe ***, ***, apartamentin me sip. 80,6 m² me nr. pasurie */**+*-*; kundrejt shumës 500.000 lekë; (ii) Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. ** kol., datë **.1.2018, me anë të së cilës shtetasit *** dhe *** **²⁹, i dhurojnë subjektit të rivlerësimit pasurinë apartamenti me nr. pasurie */**+*-*; (iii) Kartelë e pasurisë së paluajtshme për apartamentin me sip. 80,6 m², nr. pasurie */**+*-*; në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ku në rubrikën shuma e paguar rezulton vlera 2.248.740 lekë.

16.2.2. FSHU me shkresën nr. ***/* prot., datë **.3.2021, ka konfirmuar kontratën me nr. *** në emër të abonentit Artan Hajredinaj dhe referuar informacionit bashkëlidhur kësaj shkrese, kontrata është çelur në datën **.2.2006 (me adresë ***).

16.2.3. UKT me vërtetim nr. ** prot., datë **.3.2021, ka konfirmuar se shtetasi Artan Hajredinaj ka kontratë uji të lidhur me Ujësjellës-Kanalizimet Tropojë me nr. ***, që në vitin 2006 dhe në vazhdim për apartamentin e ndodhur në pall. **, sh. *, k. * ap. * lagjja “** **” sot “****”, Bajram Curri.

16.3. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, pavarësisht se nuk ka ngritur dyshime për një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” përdorimin/posedimin e pasurisë objekt verifikimi dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

16.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *Në kushtet kur unë nuk e posedoja atë apartament në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting, si dhe për sa kohë nuk gjendesha as përpara fitimit të të drejtave pasurore të një pasurie, shitjes, dhurimit apo marrëdhënies së huas, e kam konsideruar të ezauruar deklarinim tim duke përcaktuar vetëm adresën e deklarinimit në gjendje civile.*

16.5. Komisioni në përfundim ka vlerësuar se: [...] në përputhje me ligjin, subjekti duhej të deklaronte posedimin e pasurisë në Deklaratën Vetting, pasi siç rezultoi nga faktet e evidentuara gjatë procesit të hetimit, si dhe nga vetë deklarinimet e subjektit, kjo pasuri ka qenë *de facto* në pronësi të tij që nga viti 2006, pra para fillimit të detyrës. Por referuar rrethanave se: (i) u vërtetua që në periudhën e plotësimit të Deklaratës Vetting subjekti ka banuar realisht në ***, Tiranë, pasi në nëntor të vitit 2016 ishte transferuar si gjyqtar në Lezhë, pra realisht nuk ishte duke e përdorur apartamentin e përfutur nga motra në Bajram Curri; (ii) subjekti ka deklaruar në DV pasurinë si adresë banimi; (iii) u vërtetua se subjekti ka justifikuar pagesën e shumës 500.000 lekë në vitin 2005 me të ardhura të ligjshme; (iv) në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka dhënë deklarime të detajuara, si dhe dokumentacion shkresor në lidhje me apartamentin; (v) gjatë hetimit administrativ nuk u ngritën dyshime për fshehje pasurie, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit, mosdeklarimi i posedimit të pasurisë në

²⁷ Bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar Deklaratën Noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.7.2021 të shtetasve *** dhe *** **.

²⁸ Kontratë nr. rep. i palexueshëm, nr. *** kol.

²⁹ Referuar kontratës së shitblerjes rezultoi se pala shitëse është përfaqësuar me prokurorë të posaçme nr. *** rep., dhe nr. ** kol., datë **.2018 nga shtetasit *** ** (vëllai tjetër i subjektit).

Deklaratën Vetting nuk mund të ngrihet në atë nivel, sa të kualifikohet sipas nenit D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës si pamjaftueshmëri në deklaram [...].

16.6. *Komisioneri Publik*, pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 80,6 m² me nr. pasurie */**+*_**, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni pasi vëren se:

16.6.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë/posedimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë të dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datë **.3.2008 dhe në asnjë prej deklaratave periodike vjetore pasuese në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie as në deklaratën Vetting, dokument i cili është hartuar nga ligjvënësi, me qëllim plotësimin nga ana e subjekteve të rivlerësimit dhe korrigjimin e pasaktësive në mënyrën e deklarimit ndër vite, përmes së cilës asetet dhe burimet e krijimit të tyre duhet të deklarohen *plotësisht* dhe të justifikohen ligjërisht. Ky detyrim i subjekteve buron nga dispozitat kushtetuese të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe parashikimet e ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, për të deklaruar me saktësi në deklaratën “Vetting” dhe për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

16.6.2. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri, për herë të parë vetëm gjatë hetimit administrativ, vlerësohen kontradiktore, pasi në përgjigje të pyetësorit standard subjekti deklaroi se kjo pasuri është blerë nga motra e tij, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr.2 ai deklaroi se kjo pasuri është likuiduar prej tij në emër të motrës së tij që në vitin 2005.

16.6.3. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se për këtë apartament ka paguar shumën 500.000 lekë, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të provuar kohën dhe shumën e paguar, ndërsa në kartelën e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit të administruar në dosjen e ASHK-së, referohet vlera 2.248.740 lekë.

16.7. Sa më sipër, *Komisioneri Publik*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016 për deklarimin e pasurisë objekt analize, duke u ndodhur kështu në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri. Gjithashtu, në kushtet kur nga aktet në dosje nuk rezultoi të jenë administruar akte që të provojnë kohën e përfitimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerën e paguar prej tij, *Komisioneri Publik*, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mundësojnë kontrollin e organeve të rivlerësimit, lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

17. Apartament me sipërfaqe 72 m², ndodhur në Shëngjin, në pronësi të vëllait *.***.**

17.1. Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka prenotuar për vëllain *** *** një apartament në Shëngjin, me kontratë sipërmarrje datë **.12.2007 dhe se ka përdorur këtë apartament gjatë pushimeve verore.

17.1.1. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dhe: (i) Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., *** kol., datë **.12.2007 në të cilën subjekti i rivlerësimit në cilësinë e palës porositëse, ka porositur një apartament pranë shoqërisë “***-***” sh.p.k. përfaqësuar nga administratori i saj, shtetasi *** ***, në të cilën është pasqyruar edhe se *apartamenti porositet nga *** *** i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes pas regjistrimit të objektit në ZVRPP Lezhë*. Objekti i kësaj kontratë është një apartament me sip. 72 m² i ndodhur në Shëngjin Lezhë, në vlerën 30.000 euro, ku kësti i parë prej 15.000 euro është likuiduar paraprakisht dhe diferenca do të paguhet në janar 2008; (ii) kontratë shitje nr. **/**, datë **.1.2019 sipas të cilës, shtetasi *** *** ka blerë tek shoqëria “***-***” sh.p.k., me përfaqësues *** *** (administrator në vitin 2019) apartamentin nr. */**+*_* me sip. 70.075 m² i ndodhur në Shëngjin Lezhë, në vlerën 30.000 euro, shumë e cila është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***/*** datë **.12.2007.

17.2. Lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes, subjekti ka deklaruar se: (i) ka paguar këstin e parë në shumën prej 15.000 euro në datën **.12.2007 sipas mandat pagesës me përshkrimin: “*Artan Hajredinaj për *** ***”. Si burim për këtë pagesë subjekti deklaroi se: shuma prej 10.000 euro janë dërguar nga i vëllai **.***. nëpërmjet vëllait tjetër **.***. dhe familjareve të tij, ndërsa shuma prej 5.000 euro është siguruar nga vetë subjekti. Në datë **.12.2007 bashkëshortja e vëllait **.***., shtetasja **.***., i ka dërguar subjektit në llogarinë bankare shumën prej 4.804 euro³⁰; (ii) likuidimet e dy kësteve të tjera në shumën prej 8.000 euro datë **.3.2008 dhe 7.000 euro, datë 24.6.2008, janë kryer nga vetë vëllai i tij **.***., duke paraqitur mandat pagesa të cilat duket se janë nënshkruar në emër të *** **.

17.2.1. Në vijim subjekti ka deklaruar se kontrata përfundimtare e shitjes nga vëllai i tij u lidh në vitin 2019, për shkak se pasuria ishte e bllokuar në hipotekë, duke paraqitur kontratën e shitjes nr. **/**, datë **.01.2019. Bashkëlidhur kontratës është dhe vërtetimi hipotekor i datës **.12.2018 (sipas të cilit në regjistrin hipotekor nr. *** datë **.10.2008 figurojnë në pronësi të “*** **” sh.p.k. pasuria nr.*/+*-, *pasuri e lirë nga barra*).

17.3. Për sa i përket burimit të ligjshëm të të vëllait **.***. për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. ***/*** datë **.8.2018 të këtij të fundit, sipas së cilës ai deklaroi se me datë **.11.2007 ka marrë një kredi në Bankën *** në Angli dhe i ka dërguar në Shqipëri vëllait Artan Hajredinaj për blerjen e një apartamenti ndërsa këstin e dytë e ka paguar vetë. Paratë i ka dërguar dorazi nëpërmjet personave që kanë udhëtuar nga UK. Ndër të tjera, shtetasi **.***. deklaroi se *për herë të parë pas vitit 1998 ka ardhur në Shqipëri në mars të vitit 2008 dhe se ka ardhur disa herë në Shqipëri por nuk ka qenë e mundur të nënshkruajë vetë kontratën përfundimtare për shkak të vonësive të regjistrimit të objektit në ZVRPP pasi ka qenë i bllokuar nga gjykata*. Gjithashtu ai deklaroi se ky apartament nuk ka qenë asnjëherë i vëllait Artan Hajredinaj, por që shfrytëzohet nga ai gjatë kohës që nuk është në Shqipëri dhe kontratat e energjisë elektrike dhe ujit janë lidhur në emër të subjektit Artan Hajredinaj dhe më pas janë ndryshuar në emër të tij. Për të provuar burimeve të ligjshme të të vëllait, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka depozituar³¹: (i) dokument bankar për një kredi konsumator në shumën prej 15.000 Gbp të aprovuar nga banka *** ** në nëntor 2007; (ii) dokument për të ardhura nga punësimi të vëllait **.***. për periudhën 2003 – 2008.

17.4. Nisur nga një denoncim i ardhur në adresë të Komisionit³², ky i fundit ka vlerësuar se ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, apartament në Shëngjin, porositur pranë shoqërisë “***-***” sh.p.k., me administrator shtetasin *** **, person me

³⁰ Për këtë shumë subjekti deklaroi se është tërhequr në datën **.1.2008 dhe ka shërbyer për pagimin e kësteve të apartamentit të vëllait tjetër **.***.

³¹ Letër drejtuar vëllait të subjektit datë **.11.2007 dhe **.12.2007 nga Banka *** që konfirmon Marrëveshjen për kredinë 15.000 Gbp dhe skemën e kthimit të huas; ekstrakte bankare të llogarisë së vëllait të subjektit (këto dokumente janë kopje nga origjinali sipas deklarimit të noterës angleze, e cila i ka vulosur/firmosur në datën **.8.2023); printim i regjistrin digjital nga faqja zyrtare Gov.Uk, për sigurimet shoqërore të vëllait të subjektit, të cilat noterja angleze deklaroi të ketë aksesuar dhe verifikuar nga ana e saj.

³² Pranë Komisionit janë paraqitur dy denoncime anonime³², ku denoncuesit pretendojnë se familjaret e afërt të gjyqtarit Artan Hajredinaj ose vete gjyqtari kanë pasur marrëdhënie kontraktore (kontrata te ndryshme, shitblerje etj.) me kompaninë “*** **” sh.p.k. në Shëngjin, Lezhë, i quajtur ndryshe kompleksi **. Sipas tyre, subjekti ka pasuri të fshehur në emrin e familjareve dhe ka pasuri të padeklaruara e të pajustificuara të regjistruara në emër të vëllezërve dhe motrave, pra të rrethit të afërt familjar. Administratori i shoqërisë “*** **” sh.p.k. *** ** ka emëruar si përfaqësues të posaçëm të shoqërisë shtetasin *** ** (*** **), i cili ka ndryshuar disa herë emër për shkak të dënimeve që ka pasur jashtë shtetit dhe subjekti ka njohje me të. Denoncuesit i referohen faqes zyrtare të Gjykatës, ku rezultoi se subjekti:

- ka gjykuar këtë shtetas në kushtet e konfliktit të interesit dhe duke e favorizuar në tri çështje penale që i përkasin: (i) vendimit penal të datës **.04/2020, ku ka bërë zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” ndaj shtetasit *** **, dhënë me vendimin **, datë **.5.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”; (ii) vendimit penal të datës **.06/2019 me objekt zëvendësim mase sigurimi ndaj shtetasit *** ** alias *** **, (iii) vendimit penal të datës **.05/2019 me objekt miratimin e arrestit provizor dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit *** ** alias *** **;

- ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit dhe ka marrë në shqyrtim edhe çështjen civile me nr. ***/**, akti datë **.10.2021, me palë paditëse *** ** dhe palë të paditur Shoqëria “*** **” sh.p.k., me objekt lirim dhe dorëzim sendi, dhënë me vendim të Gjykatës Lezhë, datë **.04/2022, nga gjyqtari Artan Hajredinaj.

precedentë penal, të cilin duket se vetë subjekti e ka favorizuar në trajtimin e kërkesës për ekstradimin e tij.

17.5. Bazuar në sa më sipër, Komisioni referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime dhe provojë me dokumentacion se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se:

(i) subjekti e ka përdorur pasurinë rregullisht gjatë muajve të verës dhe nuk ka deklaruar sipas ligjit në Deklaratën “Vetting” përdorimin dhe burimin e krijimit të pasurisë;

(ii) subjekti ka porositur apartamentin në vitin 2007 nëpërmjet një kontrate sipërmarrjeje me administratorin e shoqërisë “***-***” sh.p.k. *** ***, pa pasur prokurë përfaqësimi nga vëllai *** ***,

(iii) lidhja e kontratës përfundimtare të shitjes nga vëllai i subjektit është bërë në vitin 2019, pra rreth 11 vite më vonë pasi pasuria ishte regjistruar në pronësi të shoqërisë ndërtimore në vitin 2008 dhe pa barrë hipotekore, ndërkohë që subjekti në mënyrë të pavërtetë ka deklaruar se kjo ka ndodhur për shkak të problemeve të regjistrimit të pasurisë;

(iv) nuk u vërtetuan të ardhurat e ligjshme të vëllait ***. ***. për blerjen e pasurisë në shumën 30.000 euro, pasuri e cila është blerë më lire se çmimi reference i EKB-së;

(v) kontrata e energjisë elektrike është lidhur në vitin 2008 në emër të subjektit të rivlerësimit dhe është ndryshuar në vitin 2017 duke kaluar në emër të vëllait të tij;

(vi) nga të dhënat e administruara rezulton që shtetasi *** (***) (***) me të cilin subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në datën *.12.2007, ka qenë i proceduar penalisht që në vitin 2005 dhe është dënuar nga Gjykata e Apelit Milano me 10 vjet heqje lirie për një vepër penale të krimit të organizuar (trafikim ndërkombëtar narkotikësh). Po kështu, nga të dhëna të sistemit TIMS rezulton se për këtë shtetas është lëshuar urdhër arresti që në vitin 2007;

(vii) subjekti i rivlerësimit ka refuzuar lejimin e ekstradimit të shtetasit *** *** alias *** *** në kundërshtim me provat dhe ligjin, duke e favorizuar atë.

17.6. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij ka kundërshtuar barrën e provës si më sipër, kaluar nga Komisioni, me të njëjtat pretendime si dhe gjatë hetimit administrativ dhe duke depozituar aktet justifikuese³³.

17.7. Komisioni, në përfundim, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, ndër të tjera ka arsyetuar se: *[...] Në përfundim të procesit, nga deklaratimet e subjektit dhe dokumentet që ai ka vënë në dispozicion provohet që shtetasi ***. ***. ka jetuar prej vitesh në Angli dhe në ditën kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes ka qenë në pamundësi objektive për të qenë prezent. Po kështu, për shkak se nuk ka qenë i pajisur me dokument identiteti në Angli me të cilin është pajisur në mars të vitit 2008, duket se ka qenë në pamundësi për të lëshuar një prokurë përfaqësimi për vëllain e tij, subjektin e rivlerësimit. Po kështu, në interpretim të nenit 78 të Kodit Civil, edhe pse subjekti i rivlerësimit ka qenë një përfaqësues pa një prokurë përfaqësimi (pa tagër) i vëllait të tij ***. ***. në lidhjen e kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007, ky i fundit ka miratuar veprimin juridik të kryer prej subjektit pasi në mënyrë konkludente ka shfaqur vullnetin për porositjen e apartamentit nëpërmjet kryerjes se pagesave për blerjen e tij, si dhe ka nënshkruar kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë në vitin 2019, duke përmbushur një nga kushtet e kontratës së sipërmarrjes e cila parashikon se: “Apartamenti porositet nga ***. ***. i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes pas regjistrimit të objektit në ZVRPP Lezhë”. Në lidhje me pikëpyetjen e ngritur për kalimin e pronësisë në emër të blerësit (vëllait) 11 vite pasi pasuria ka qenë e regjistruar në pronësi të shoqërisë ndërtimore dhe pa barrë hipotekore, subjekti pretendon se nuk qëndron, pretendim i cili pjesërisht u vlerësua i bazuar referuar shkresës kthim përgjigjeje të datës *.2.2024 të lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Lezhë, paraqitur me parashtrime. Sipas kësaj shkrese, me vendimin penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*

³³ Referohuni akteve të depozituara nga subjekti me parashtrimet e tij ndaj Rezultateve të hetimit administrativ.

Lezhë nr. ***, datë **.6.2015, është vënë në sekuestro preventive mbi pasurinë nr. *+*-* të llojit apartament regjistruar në pronësi të shoqërisë “*** ***” sh.p.k. Pra, justifikohet kështu moskalimi i pronësisë pas vitit 2015, por mbetet e paqartë përse kontrata e shitjes nuk është lidhur përpara këtij viti. Gjithsesi, në përfundim çmohet se periudha e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes në emër të vëllait të subjektit është një zgjedhje e palëve me vullnet të lirë dhe parë në këtë këndvështrim, një rrethanë e tillë më vete, nuk mund të përbëjë shkak për dyshime që kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, për më tepër që në përfundim të procesit mbeten të pavërtetuara dyshimet për një pasuri të fshehur të tij. Në lidhje me konstatimin se apartamenti është blerë më lirë se çmimi i referencës së EKB-së, subjekti paraqiti 4 kontrata sipërmarrjeje të realizuara në vitin 2007 për pasuri të tjera të ndodhura në të njëjtën godinë dhe të lidhura me të njëjtin sipërmarrës dhe duke iu referuar çmimit të tyre parashtron se nuk mund të ketë asnjë dyshim për çmimin e blerjes së apartamentit nga vëllai, për sa kohë ka qenë vullnet i lirë kontraktor i të dyja palëve, i përputhur ky edhe me kontratat e ngjashme të paraqitura. Sa i takon burimit të të ardhurave të vëllait për blerjen e apartamentit, në analizë të parashtrimeve dhe provave të administruara të cilat vërtetojnë të ardhurat e vëllait të subjektit në emigracion si dhe në konsideratë të faktit që Komisioni është në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të vëllait të subjektit i cili ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që në vitin 1999, në përfundim të procesit nuk mund të arrihet në përfundimin se z. ***, ***, ka qenë në pamundësi financiare për të blerë apartamentin. Veç sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të depozituar dokumentacion të plotë për të ardhura të ligjshme nga punësimi për të ndjerën bashkëshorten e z. ***, znj. ***, ***, për të cilën ka depozituar vetëm dy fletëpagesa ku evidentohet se pagesat javore janë ndjeshëm më të larta se e z. ***, pothuaj sa 3-fishi. Për më tepër, në lidhje me bashkëshorten e vëllait, u provua nga të dhënat bankare se i ka transferuar subjektit shumën 4.804 euro, sipas subjektit për pagesën e kësteve të apartamentit, si dhe u vërtetua se në dhjetor 2007 të dy së bashku (vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij) kishin marrë një kredi konsumatore prej 15.000 Gbp. Pra, sipas këtyre të dhënave duket se bashkëshortja e vëllait ka përfutur të ardhura të cilat mund të kenë shërbyer si të ardhura të tjera përveç atyre të vëllait të subjektit, që i kanë mundësuar familjes mbulimin e shpenzimeve jetike.

Lidhur me kontratën e energjisë elektrike me datë çeljeje **.7.2008 në emër të subjektit, i cili në datën **.9.2017 ka ndryshuar nga Artan Hajredinaj në ***, ***, vlerësohet i drejtë pretendimi i subjektit pasi, siç është evidentuar edhe në raste të tjera të ngjashme nga Komisioni, lidhja e kontratave së energjisë elektrike është bërë në jo pak raste në emër të shtetasve që ishin shënuar në kontratat e porosive/sipërmarrjeve. Ndërsa në seancë dëgjimore, pasi është pyetur në lidhje me faktin se nga kush janë paguar shpenzimet e energjisë, subjekti ka deklaruar se faturat e dritave shkonin tek shtëpia në Shëngjin, Lezhë dhe se, me sa mban mend, duhet të jenë paguar nga vëllezërit kur vinin në Shqipëri. Ky deklaram vlerësohet i arsyeshëm në kushtet kur u vërtetua që subjekti deri në fund të vitit 2016 ka jetuar në Tropojë (më pas në Tiranë).

Sa i takon konstatimeve në lidhje me administratorin e shoqërisë “*** ***” sh.p.k. ***, ***, alias ***, ***, i cili ka qenë person me precedentë penalë në vitin 2007 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes për apartamentin e vëllait në Shëngjin, subjekti parashtrori se nuk ka pasur asnjë njohje personale dhe se në atë periudhë ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ku nuk ka trajtuar çështje gjyqësore me palë pjesëmarrëse shoqërinë ndërtimore apo administratorin e saj. Po kështu, subjekti ka dhënë sqarime e dokumente në lidhje me trajtimin e një çështjeje me objekt ekstradimin e shtetasit ***, ***, alias ***, për të cilin janë ngritur dyshime për favorizim nga ana e tij si gjyqtar i çështjes në vitin 2019, duke pretenduar se nuk e ka favorizuar këtë shtetas. Siç rezultoi në përfundim të procesit, u vërtetua se: (i) në kohën e porositjes së apartamentit (dhe jo vetëm) nuk vërtetohet që subjekti të ketë pasur njohje me administratorin e shoqërisë apo të ketë

*trajtuar çështje ku ai dhe shoqëria të kenë qenë palë në gjykime; (ii) nuk vërtetohet që subjekti të ketë favorizuar shtetasin ***, ***, alias ***, ***. (trajtuar hollësisht gjatë vlerësimit të aftësive profesionale dhe figurës).*

*Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit çmohet se subjekti ka arritur të japë sqarime bindëse bazuar në fakte e dokumente në lidhje me rrethanat që kane çuar Komisionin në dyshime për një pasuri të mundshme të fshehur të tij mbi apartamentin në Shëngjin në pronësi të vëllait ***, ***, duke vërtetuar se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016 [...].*

17.8. *Komisioneri Publik, për sa më sipër, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa më poshtë vijon:*

17.8.1. *Sikurse ka rezultuar nga hetimi administrativ, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “**** ****” sh.p.k., datë **.12.2007, në cilësinë e porositisit, duke u sjellë kështu si posedues i vetëm i ligjshëm i pasurisë deri në vitin 2019, kur është lidhur kontrata e shitjes në emër të të vëllait ***,***. Këto veprime juridike të pretenduara të kryera në emër të vëllait ***,***., janë bërë në mungesë të një akti përfaqësimi, prokure, e cila referuar përcaktimeve të parashikuara në Kodin Civil mbi të drejtën e përfaqësimit, do të saktësonte të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të kryer veprime juridike në emër e për llogari të një personi tjetër, vëllai në këtë rast, sikundër duket se ka vepruar subjekti në raste të ngjashme të përfaqësimit të vëllait tjetër ***,***., apo të motrës ***,***..*

17.8.2. *Në emër të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar dhe kontrata e lidhur për furnizimin me energji elektrike, për të cilin subjekti ka kërkuar ndryshimin e emrit në kontratën me këtë operator vetëm në datë **.9.2017³⁴.*

17.8.3. *Subjekti përveç nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, rezulton se ka kryer dhe pagesën/depozitimin në cash në arkën e shoqërisë në datën **.12.2007 (kohë në të cilën ushtronte detyrën e gjyqtarit).*

17.8.4. *Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar mbi këtë marrëdhënie juridike/financiare të krijuar dhe zhvilluar pa titull përfaqësimi si në formularët e deklarimit të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI për periudhën 2008-2016, ashtu dhe në Deklaratën “Vetting”, si dhe nuk ka qartësuar këtë marrëdhënie as në vitin 2014, i thirrur në ILDKPKI.*

17.8.5. *Në këto kushte, duke konsideruar faktin se për këtë pasuri subjekti ka vepruar me tagra të plota posedimi deri në vitin 2019, kur është lidhur kontrata e shitblerjes nga i vëllai, në mungesë të një akti ligjor përfaqësimi, ka përdorur pasurinë rregullisht për pushimet vjetore sipas deklarimeve të tij dhe ka rezultuar abonent në kontratat e energjisë elektrike deri në vitin 2016, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit më së paku ka kryer deklarim të pasaktë për këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore dhe atë Vetting, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016.*

17.8.6. *Përveç sa më sipër, nisur nga dyshimet e Komisionit për të cilat i është kaluar dhe barra e provës, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të provonte burimet e ligjshme të të vëllait ***,***., të cilat në përfundim të këtij procesi, vlerësohet se mbetën të paprovuara në mënyrë shteruese.*

17.8.7. *Komisioneri Publik vlerëson se konkluzioni i Komisionit se: fakti se Komisioni është në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të vëllait të subjektit i cili ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që në vitin 1999, në përfundim të procesit nuk mund të arrihet në përfundimin se z. ***, ***, ka qenë në pamundësi financiare për të blerë apartamentin nuk është në përputhje me frymën e ligjit dhe qëllimin e këtij procesi. Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, nuk u provua në mënyrë shteruese as burimi i ligjshëm i të vëllait ***,***. nga punësimi në shtetin anglez dhe as mënyra se si këto fonde janë sjellë në shtetin shqiptar (sikundër është provuar pjesërisht për transfertën e bashkëshortes së të vëllait në llogari të subjektit të rivlerësimit me përshkrimin për blerje banese).*

³⁴ Konfirmuar me shkresë kthim përgjigje të FSHU-së nr. ***/* prot., datë **.10.2023.

17.9. Në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, çështjet e trajtuara më sipër, janë çështje që duhet të analizohen dhe trajtohen nga Kolegji në vlerësim tërësor së bashku me shkaqet e tjera trajtuar në këtë ankim, në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

18. Çështje të tjera

18.1. Kredi pranë FFZM Dega Tropojë, në shumën 3.000.000 lekë, përfituar datë **.8.2006 dhe mbyllur në dt. **.9.2007

18.1.1. Në D.-Vetting subjekti ka deklaruar: *Kredi e marrë me dt. **.8.2006, pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore, Dega Tropojë sot Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit, Dega Tropojë, në shumën 3.000.000 lekë, e cila është mbyllur në dt. **.9.2007, ku afati ka qenë tre vjet dhe interesi 15% ku në përfundim janë paguar 3.269.019 lekë nga këto 269.019 lekë interesa.*

18.1.2. Në deklaratën dorëzuar në ILDKPKI datë **.10.2014 format “Para fillimit të detyrës”, subjekti ka deklaruar këtë kredi dhe detyrimin e mbetur në shumën 1.207.590 lekë.

18.1.3. Agrokredit sh.a.³⁵ me shkresën nr.***/* prot., datë **.9.2023 konfirmon ndër të tjera se, subjekti është financuar me një kredi në shumën 3.000.000 lekë sipas kontratës së huas nr. ***/** datë **.8.2006 me afat 36-mujor, me objekt “Rikonstruksion të një lokali tregtimi dhe blerje pajisje për kompletimin e tij”. Kredia është mbyllur në datën **.9.2007, pra para afatit, periudhë në të cilën subjekti ka qenë në detyrë dhe nuk rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj kredie apo burimi e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e saj.

18.1.4. Në përfundim të hetimit administrativ Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 pasi ka rezultuar se: (i) kredia, shlyerja e saj si dhe burimi i të ardhurave për shlyerjen e saj nuk janë deklaruar në DPFDF 2008 dorëzuar në datë **.03.2008 dhe as në DV dorëzuar në datën **.10.2014 nga ana e subjektit; (ii) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të shlyer kredinë para afatit për shkak të balancës negative prej - 2.105.256 lekë.

18.1.5. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se kredia është përdorur për ndërtimin e njësisë së shërbimit ndodhur në Bajram Curri, shlyerja e parakohshme e kredisë ka si burim shitjen e dy apartamenteve në **.5.2007 në vlerën 2.000.000 lekë dhe pjesa tjetër është mbuluar me të ardhura të kursyera nga pagat apo shitja e pasurive të paluajtshme si dhe kredia është shlyer në muajin shtator 2007, dhe si rrjedhim nuk është deklaruar pasi në deklarimin e dorëzuar në ILDKPKI në mars 2008 ky detyrim ka qenë i mbyllur.

18.1.6. Komisioni, në përfundim ka vlerësuar se: [...] *Në analizë të parashtrimeve vlerësohet se sqarimet e subjektit qëndrojnë pjesërisht, pasi sa i takon pretendimit se kjo kredi ka shërbyer për ndërtimin e shtesës mbi njësinë me sip. 105.8 m² nuk duket i provueshëm, për sa kohë që si në DPFDF-në e dorëzuar në datën **.3.2008, në deklaratën Vetting ashtu edhe në pyetësonin nr. 2 subjekti nuk e ka deklaruar si burim për ndërtimin e shtesës. Por, nga ana tjetër, duket e besueshme se një pjesë e kësaj kredie mund të ketë shërbyer duke qenë se në kohën e marrjes së saj subjekti ishte në proces e sipër të pajisjes me leje ndërtimi për shtesën, si dhe në DPFDF-në e dorëzuar në datën **.10.2014 edhe pse nuk e ka deklaruar si burim për ndërtimin e shtesës, tek rubrika e detyrimeve financiare subjekti e ka deklaruar si detyrim me përshkrimin “Për ndërtim shtesë objekti”. Sa i takon mosdeklarimit në DPFDF me datë **.3.2008 dhe DPV-në për vitin 2007 të dorëzuar në datën **.10.2014, shpjegimet e dhëna nga subjekti qëndrojnë pasi në DPFDF të dorëzuar në datën **.3.2008 subjekti ka deklaruar detyrimet aktive dhe kjo kredi ishte mbyllur që në datën **.9.2007, pra subjekti nuk kishte më detyrime financiare për shlyerjen e saj. Sa i takon mundësisë për shlyerjen e kredisë, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit qëndrojnë pasi në dukje të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të paluajtshme janë gjeneruar pas datave kur është bërë shlyerja e pjesës*

³⁵ Institucioni financiar që ka përthithur FFZM.

më të madhe të kredisë, por nga leximi i kontratave rezulton se në mënyrë specifike është pasqyruar që pagesat janë kryer para përpilimit të tyre dhe jashtë zyrës noteriale. Pra, pavarësisht se kontratat për shitjen e pasurive janë lidhur në datat **.5.2007, **.5.2007 dhe **.12.2007, të ardhurat janë gjeneruar para këtyre datave dhe si të tilla ato mund të kenë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë në FAF, ku pjesa më e madhe prej 2.224.250 lekësh është kryer në periudhën **.4.2007 – **.6.2007. Në përfundim të rishikimit të analizës financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e kredisë së marrë [...].

18.1.7. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se ky konkluzion i Komisioni nuk mbështetet në aktet në dosje. Për sa i përket përdorimit të kësaj kredie, sikundër trajtuar dhe në analizimin e pasurisë “Njësi shërbimi” ndodhur në Bajram Curri, nuk rezulton që ajo të jetë deklaruar si burim për këtë pasuri, përkundrejt qëllimit të përcaktuar në kontratë.

18.1.8. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurive sipas kontratave të maj 2007 dhe prezumimi i Komisioni se të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre gjatë vitit 2007, mund të jenë gjeneruar përpara datës së përpilimit të kontratave të shitjes, mbetet i pambështetur në akte të tjera provuese. Nisur dhe nga sa trajtuar në dhe konkulduar mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip.113,2 m² me adresë Tiranë dhe shlyerjes së pagesave për të gjatë vitit 2007, pretendimi i subjektit mbi përdorimin e të ardhurave nga këto shitje, konsiderohet i pambështetur.

18.1.9. Gjithashtu bazuar dhe në deklarinimin e subjektit në deklaratën periodike vjetore dorëzuar në datën **.10.2014 për vitin 2007 (në të cilën duket se ka deklaruar për 31.12.2007), në të cilin subjekti ndër të tjera ka deklaruar dhe posedim në cash të shumës 3.300.000 lekë, shtuar gjendje cash në banesë me të ardhurat nga shitja e apartamenteve, pretendimet e tij gjatë hetimit administrativ mbi përdorimin e këtyre të ardhurave për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2007, duken jo të besueshme.

18.1.10. Sa më sipër, në kuadër dhe të mungesës së deklarinimit në kohë reale të detyrimeve dhe pasurive të luajtshme e të paluajtshme nga ana e subjektit në vitin 2007 dhe mungesës së deklaratës përpara fillimit të detyrës, dorëzuar në kohë reale në organet përgjegjëse, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka bërë deklarinim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë detyrim dhe shlyerjen e parakohshme të tij, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016³⁶.

18.2. Kursime në cash në shumën 10.000 euro

18.2.1. Në D-Vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje cash në banesë në vlerën 10.000 euro. Burimi i krijimit nuk deklarohet. Pjesa takuese 50%.

18.2.2. Në DV – 2011, subjekti ka deklaruar: shtuar gjendja cash në shumën 1.500.000 lekë me burim: shitur një apartament në B. Curri.

18.2.3. Në DV-2013, subjekti ka deklaruar shtuar gjendja cash në banesë në shumën 500.000 lekë.

18.2.4. Në deklarinimet e tjera subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar ndryshime, shtesa apo pakësime të kursimeve në cash, dhe as ti ketë deklaruar këto kursime si burim për mbulimin e ndonjë shpenzimi të deklarueshëm.

18.2.5. Gjatë hetimit administrativ, lidhur me kursimet në cash, subjekti ka deklaruar se³⁷: shuma prej 10.000 euro është akumuluar gjatë periudhës 2011-2016, duke saktësuar se në vitin 2011 ka deklaruar gjendje cash në vlerën prej 1.500.000 lekë, me të ardhura nga shitje pasurie,

³⁶ Në këtë kuadër, në vlerësimin e Komisionerit Publik duhet të trajtohet dhe pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni lidhur me “Kontratë kredie dt. **.1.2007, marrë nga b/shortja në *** Bank, në shumën 800.000 lekë, likuiduar, për të cilën Komisioni në përfundim të hetimit administrativ i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti dhe b/shortja e tij nuk kanë pasur mundësi për të shlyer kredinë para afatit dhe mbuluar shpenzimet e tjera familjare, për shkak të një balance negative prej - 139.407 lekë; (ii) kredia dhe shlyerja e saj nuk janë deklaruar në deklaratat DPF 2008 dhe DV-2009/2010.

³⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

ndërsa në vitin 2012 nuk ka deklaruar shtesë/pakësim të gjendjes *cash*. Në vitin 2013 ka deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në vlerën 500.000 lekë me burim të ardhurat nga puna e tij dhe b/shortes, ndërsa në DV-2014 ka pakësuar shumën *cash* në vlerën 700.000 leke për shkak të disa shpenzimeve të atij viti por që ka harruar të deklarojë këtë pakësim pasi ka menduar se ka qenë ezaurues në shpjegimet dhënë në ILDKPKI në vitin 2014³⁸. Gjendja *cash* prej 1.300.000 lekë është mbartur në vitin 2015 ku nuk janë deklaruar shtesa/pakësime dhe në vitin 2016 është deklaruar gjendja *cash* prej 10.000 euro (ekuivalenti i shumës 1.300.000 lekë), gjendje që është deklaruar dhe në Deklaratën “Vetting”.

18.2.6. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vlerësuar se: [...] *nisur nga: (i) deklarimi i gjendjes cash në datën që janë dhënë sqarimet në ILDKPKI datë **.10.2014; (ii) deklarimi i shpenzimeve për mobilim në shumën prej 600.000 lekë dhe shpenzime për energji elektrike në shumën prej 300.000 lekë në DV-2014; (iii) sqarimet e subjektit në pyetësorin nr. 2 mbi shpenzimet e kryera në vitin 2014, duket se subjekti ka patur gjendjen prej 1.300.000 lekë në fund të vitit 2014, gjendje që është mbartur dhe në vitin 2015. Në vitin 2016 gjendja cash prej 10.000 euro e deklaruar dhe në deklaratën Vetting, duket të jetë ekuivalenti i shumës së mbartur prej 1.300.000 lekë. Në përfundim të hetimit rezulton se gjendja cash e mbartur deri në fund të vitit 2016 dhe në deklaratën Vetting në shumën prej 10.000 euro është pasuri me të ardhura të ligjshme [...].*

18.2.7. Komisioneri Publik vëren se shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi pakësimin/përdorimin e kursimeve *cash* gjatë periudhës 2011-2016, nuk përputhen me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, pasi në DV-2014, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në shumën 700.000 lekë. Në këtë deklaratë janë deklaruar shpenzime mobilimi në shumën 600.000 lekë dhe shpenzime për energji elektrike në shumën 300.000 lekë, por nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të këtyre shpenzimeve apo pakësimi i kursimeve *cash*.

18.2.8. Sa më sipër bazuar dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit lidhur me kursimet *cash*, Komisioneri Publik çmon si të pabazuar analizën e Komisionit dhe pakësimin e kursimeve në *cash* në shumën 700.000 lekë në vitin 2014, çka do të rezultonte në mungesë e burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2014, në shumën – 445.876 lekë.

18.3. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni D pika 3 dhe 5 e aneksit të Kushtetutës, dhe vlerësohet se çështjet e trajtuara më sipër, duhet të analizohen dhe trajtohen nga Kolegji në vlerësim tërësor së bashku me shkaqet e tjera trajtuar në këtë ankim, në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. B - Lidhur me profesionalizmin dhe etikën

III. B/1 - Vlerësimi i aftësive profesionale

19. Komisioni, për vlerësimin e aftësive profesionale, është bazuar në këto burime të vlerësimit: (i) Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, miratuar nga KLGJ dhe (ii) Denoncimet e publikut.

20. Në aktin “Rezultatet e hetimit administrativ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës dhe ka kërkuar shpjegime për disa çështje që referohen në denoncimet e mëposhtme, në rrjedhë kronologjike numerike, të cilat do të gjejnë trajtim në vijim.

21. Denoncim I,³⁹ ku denoncuesi pretendon se në të gjitha vendimet e dhëna nga subjekti, me objekt “*ulje dënimi*”, subjekti ka pranuar kërkesat e tyre në kundërshtim me ligjin pasi të dënuarit nuk kishin plotësuar afatin 1 vit. Sipas denoncuesit, këto vendime janë dhënë në kohën

³⁸ I pyetur nga inspektori përgjegjës, subjekti ka deklaruar posedim të kursimeve në *cash* në atë vit në shumën 1.300.000 lekë.

³⁹ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë **.8.2023.

2016-2020, kur Gjykata e Lezhës ishte kompetente për të dënuarit në burgun e Shënkollit dhe subjekti ishte i vetmi që i pranonte këto kërkesa, duke sjellë shumë pasoja ligjore në llogaritje të ndryshme në dinamikën e dënimit.

21.1. IIEVP Lezhë⁴⁰ i ka përcjellë Komisionit, 5 vendime të dhëna nga subjekti, shoqëruar me praktikën përkatëse, nga shqyrtimi i të cilave ka konstatuar se në të 5 rastet⁴¹, nga ulja e mëparshme e dënimit, deri në datën e vlerësimit nga ky institucion, nuk ishte plotësuar afati i vlerësimit 1-vjeçar, i parashikuar në nenin 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

21.2. Komisioni iu drejtua sërish IIEVP Shënkoll, Lezhë, që të vërë në dispozicion vendime të dhëna nga gjyqtari Artan Hajredinaj, ku ka vendosur rrëzimin e kërkesave të të dënuarve me objekt “Ulje dënimi” në bazë të nenit 63 të ligjit nr. 8328/1998, për shkak të mosplotësimit të afatit kohor prej 1 viti. Me shkresën nr. *** prot., datë **.1.2024, IIEVP Shënkoll Lezhë i ka përcjellë Komisionit, dy vendime⁴² të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

21.3. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit lëshuar nga IIEVP Lezhë, për secilin prej të dënuarve *** ***, *** ***, *** ***, *** ***, *** ***, dhe “Vlerësimit të sjelljes” së tyre për në Gjykatë, nga IIEVP Lezhë, rezultojnë se të dënuarit kanë treguar sjellje të mirë, *por për arsye se ata nuk plotësojnë afatet kohore prej 1 viti nga ulja e fundit, propozohet rrëzimi i kërkesës me objekt “Ulje dënimi”*.

21.4. Nga aktet e administruara në dosje, konstatohet se subjekti ka pranuar kërkesa për ulje dënimi, kur nga ulja e mëparshme në rastin e shtetasit *** ***, nuk kishin kaluar as 9 muaj kur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr.*** datë **.10.2016 kishte përfituar ulje në masën 90 ditë; në rastin e shtetasit *** ***, nuk kishin kaluar as 10 muaj kur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr.** datë **.1.2017 kishte përfituar ulje në masën 90 ditë; në rastin e shtetasit *** ***, kur kishin kaluar vetëm 10 muaj kur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr.** datë *.2.2017 ka përfituar ulje në masën 90 ditë; në rastin e shtetasit *** ***, kur kishin kaluar vetëm 6 muaj pasi në datën **.1.2017 ka përfituar uljen e mëparshme; në rastin e shtetasit *** ***, nuk kishin kaluar as 10 muaj muaj pasi në datë **.11.2016 ka përfituar uljen e mëparshme. Pra në të 5 rastet nga ulja e mëparshme deri në datën e vlerësimit nuk ishte plotësuar afati i vlerësimit 1-vjeçar i parashikuar në nenin 63 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

21.5. Komisioni, në aktin⁴³ “Rezultatet e hetimit administrativ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se: [...] *Subjekti i rivlerësimit në 5 rastet, ka pranuar kërkesat për “Ulje dënimi”, jo në përputhje me kriteret e nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, pasi nuk është përmbushur kushti objektiv, afati kohor prej 1 viti, ashtu siç është shprehur IIEVP Lezhë, sikurse ka arsyetuar në dy raste të tjera, për rrëzimin e kërkesave, konkretisht vendimin nr. ***, datë **.12.2016 dhe nr. ** datë **.11.2017 [...].*

21.6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴⁴, është shprehur se: [...] *Në të pestë rastet kur unë me vendim kam pranuar pjesërisht kërkesën për ulje dënimi, kemi të*

⁴⁰ Shkresë nr.*** prot., datë **.11.2023 të IIEVP Lezhë.

⁴¹ Me vendimin nr. ***, datë **.7.2017, subjekti i ka vendosur pranimin e kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë etj.; Me vendimin nr. ***, datë **.11.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë; Me vendim nr. ***, datë **.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë; Sipas dispozitivit të vendimit nr. **-2017-***, datë **.7.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 45 ditë; Me vendimin nr. ***, datë **.9.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë.

⁴² Me vendimin nr. ***, datë **.12.2016, me kërkesë *** ***, me objekt ulje dënimi, subjekti ka rrëzuar kërkesën, pasi nuk ka kaluar afati 12-mujor nga shqyrtimi i kërkesës së fundit për ulje dënimi. Me vendimin nr. **, datë **.11.2017, me kërkesë *** ***, me objekt ulje dënimi, subjekti ka rrëzuar kërkesën, pasi rezultoi se i dënuari nuk i ka vuajtur 12 muaj burgim nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

⁴³ Referohuni f. 61-62 të aktit.

⁴⁴ Referohuni f. 6-7 të prapësimeve të subjektit, kriterit të aftësive profesionale.

bëjmë me ulje jo në uljen maksimale që parashikon ligji prej 90 ditë, por në një ulje të pjesshme konkretisht 60 ditë. Në këto raste të dënuarit kanë paraqitur kërkesë për ulje dënimi nëse vendimi i formës së prerë është i 1 viti të mëparshëm dhe se vendimi i pranimit pjesërisht të kërkesës është i një viti të mëpasshëm kalendarik... Neni 63 i ligjit nr. 8328 datë 16.4.1998 ka përcaktuar se: “Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit. Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës mbi kërkesën e të dënuarit të prokurorit ose të drejtorit të institucionit ”. Duke interpretuar këtë dispozitë kam vlerësuar se fakti që nuk është bërë ulje në masën 90 ditë, por është aplikuar kjo ulje në masën 60 ditë është përcaktim ligjor, si e drejtë që duhet t’u jepet të dënuarve [...].

21.7. Komisioni ka arritur në përfundimin se [...] *Subjekti ka vepruar sipas interpretimit të nenit 63 të ligjit nr. 8328/1998, pasi kërkesat për të cilat ka vendosur ulje të pjesshme të dënimit i ka marrë në shqyrtim në vitin kalendarik pasardhës nga ai i përfitimit të uljes së mëparshme. Mbi të njëjtin interpretim subjekti ka refuzuar uljen e dënimit për dy rastet e tjera. Pra, duke qenë se ligji i mëparshëm, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes së vendimeve, ka pasur vend për interpretim, duke lënë në analizën e provave dhe bindjen e gjyqtarit për të vendosur se cila ishte ulja që të dënuarit mund të përfitonin, një ose disa ulje, si dhe deri në 90 ditë si ulje maksimale, pretendimi i subjektit vlerësohet i bazuar. Për më tepër, këto vendime nuk janë ankimuar nga institucioni përkatës, pra nuk i janë nënshtruar shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë nëse kërkesat duhen pranuar ose jo. Gjithsesi, kjo i përket zgjidhjes në themel të çështjes dhe në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit*⁴⁵[...].

21.8. Komisioneri Publik, vlerëson se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, si gjyqtar i vetëm ka marrë vendimet (5 raste) me objekt “Ulje dënimi”, në zbatim të gabuar të nenit 63 të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 , “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, kjo gjetje duhet të përfshihet në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj. Në kuptim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procedura e rivlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, neni 72 i ligjit nr. 96/2016, ka përcaktuar indikatorët mbi të cilët vlerësohen aftësitë profesionale të gjyqtarit. Në pikën 2 të kësaj dispozite, parashikohet si indikator aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin.

21.9. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit në 5 vendimet e dhëna për “Ulje dënimi”, ka treguar mangësi në aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, duke mos treguar kujdes në drejtim të zbatimit të nenit 63, ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar, ku pika 1 e tij që parashikon se *të dënuarit mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit, duhet lexuar dhe interpretuar në harmoni me pikën 2 të tij që parashikon se, për dhënien e këtij shpërblimi vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.* Këto, së bashku, rregullojnë përfitimin e uljes së dënimit për të dënuarin, vetëm pas plotësimit të kriterit të kalimit të afatit 12 mujor nga shqyrtimi i kërkesës së fundit të të dënuarit.

21.10. Komisioneri Publik konstaton se në 5 vendimet e dhëna⁴⁶ për të dënuarit, subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar për sa i përket provueshmërisë së fakteve të dhëna në aktet

⁴⁵ Referohuni f. 47 të vendimit të Komisionit.

⁴⁶ Vendimi nr. ***, datë **7.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë etj.; Me vendimin nr. ***, datë **11.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë; Me vendim nr. ***, datë **12.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë; Sipas dispozitivit të vendimit nr. **-2017-***, datë **7.2017, subjekti

“Vlerësim sjelljeje” të lëshuara nga I EVP-ja, që është organ ndihmës për gjykatën në këto lloj gjykimesh, që në të gjitha rastet ka propozuar rrëzimin e kërkesës për mosplotësim të afateve kohore prej 1 viti nga ulja e fundit për të dënuarin. *Komisioneri Publik*, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e çmuarjes drejt të provës/ akteve, “Vlerësim sjelljeje” të lëshuara nga I EVP-ja, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteri i parashikuar në pikën 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

21.11. *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, në vendimet penale me objekt “Ulje dënimi”, për zbatimin e nenit 63 ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material. Mangësitë e konstatuara afektojnë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

22. Denoncim II, ku ankuesit pretendojnë se subjekti në kundërshtim me ligjin ka dhënë vendimin nr. ** datë **.4.2020, me objekt “Ulje dënimi” që i përket kërkesës së të dënuarit *** ***. Subjekti ka realizuar seanca në kohën e pandemisë kur nuk zhvillohej asnjë seancë gjyqësore, në kundërshtim me aktin normativ dhe ligjin. Kërkesa e të dënuarit *** *** ishte rrëzuar me parë nga gjyqtarja pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë, *** ***. Pas ankimit të Drejtorisë së Burgjeve ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit, Gjykata e Apelit Shkodër e ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar kërkesën e shtetasit *** ***.

22.1. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë⁴⁷ dosjen gjyqësore që i përket vendimit datë **.4.2020, me kërkues *** *** dhe me objekt “Ulje dënimi”, nga shqyrtimi i të cilës rezultoi se:

22.1.1. Me kërkesë datë **.11.2019, *** ***, i padënuar më parë, me masë sigurimi arrest në burg, ka kërkuar uljen e dënimit me 270 ditë, për 3 vitet e vuajtjes së dënimit... si dhe lirimin para kohe me kusht të të dënuarit.

22.1.2. Sipas aktit “Vlerësim sjelljeje”, datë **.10.2019, të lëshuar nga I EVP-Shkodër që është organ ndihmës për gjykatën në këto lloj gjykimesh, është konkluduar se *** *** nuk plotëson kriteret ligjore për të përfutur ulje dënimi pasi vendimi ka marrë formë të prerë më datë **.6.2019 dhe në kushte të tilla, ka propozuar rrëzimin e kërkesës së tij me objekt ulje dënimi.

22.1.3. Sipas aktit “Vlerësim sjelljeje”, datë **.2.2020, të lëshuar nga I EVP-Shkodër ka propozuar rrëzimin e kërkesës për mosplotësim afatesh kohore.

22.1.4. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të lëshuar nga I EVP-Shkodër rezultoi se i dënuari është arrestuar më datë **.7.2016 dhe është dënuar me 8 vite e 8 muaj burgim dhe vendimi ka marrë formë të prerë më datë **.6.2019, pra ai ka kryer gjithsej 5 vite e 2 muaj burgim, si dhe i mbeten për të vuajtur edhe 3 vite e 5 muaj burgim.

22.1.5. Me vendimin nr. ** datë **.4.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur uljen e dënimit për të dënuarin *** ***, për dënimin e mbetur të pavuajtur me 270 ditë që i përket vendimit nr.*** datë **.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.** datë **.6.2019 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, duke arsyetuar ndër të tjera se : [...] *Pra fillimi i vuajtjes së dënimit për kërkuesin *** *** është datë **.7.2016 që është data e arrestimit të tij në ekzekutim të vendimit penal nr. ***, datë **.7.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë [...].*

22.1.5.1. Gjykata konstaton se kërkuesi *** *** statusin e të dënuarit e ka marrë më datën **.6.2019 me vendimin nr. ** të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kur i ka lindur dhe e drejta për të kërkuar ulje dënimi dhe në rrethanat kur vuajtja e dënimit për kërkuesin ka filluar më datë **.7.2016, kërkuesit i lind e drejta për të kërkuar ulje dënimi për një periudhë

i rivlerësimit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 45 ditë; Me vendimin nr. ***, datë **.9.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së *** ***, uljen e dënimit në masën 60 ditë.

⁴⁷ Me shkresën nr. ***/* prot., datë **.12.2023 të GJSHPIP Lezhë.

3 vjeçare. Kërkuesi për periudhën **.7.2016 deri **.6.2019, kur vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të përfitojë nga 90 ditë për çdo vit të vuajtjes së dënimit [...].

22.1.6. Kundër vendimit nr.** datë **.4.2020 ka paraqitur ankim IEVP Shkodër, duke parashtruar se nga data **.7.2016-**.6.2019, shtetasi *** *** ka pasur statusin e të paraburgosurit, dhe se Ulja e dënimit, sipas nenit 63 të ligjit 8328, dt. 16.4.1998, është një e drejtë që i njihet të dënuarit...vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

22.1.7. Me vendimin nr. *** datë **.10.2020, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.** datë **.4.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke rrezuar kërkesën e kërkuesit *** ***.

22.2. Komisioni, në aktin⁴⁸ “Rezultatet e hetimit administrativ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se: [...] (i) *Subjekti i rivlerësimit, jo në përputhje me kriteret e nenit 63 ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ka pranuar kërkesën e të dënuarit *** *** për ulje dënimi për periudhën e qëndrimit në paraburgim. Po kështu, duket se nuk ka vepruar në përputhje me nenin 75/3 të ligjit “Për të drejtat e të dënuarve”;* (ii) *objekti i gjykimit në këtë proces gjyqësor penal nuk është nga ato raste të parashikuara sipas pikës 3 të nenit 3⁴⁹ të aktin normativ nr. 9 datë 25.3.2020, për të cilat lejohet zhvillimi i seancave [...].*

22.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁰, është shprehur se: [...] *I dënuari ***. ***. është dënuar me vendim të formës së prerë të datës **.6.2019, por që nga data e arrestimit të tij **.7.2016 e deri më **.6.2019 ky i dënuar kishte qëndruar për afro 3 vite në kushte paraburgimi, duke mos përfituar asnjë lloj ulje dënimi... Meqenëse kërkesa e këtij të dënuari është paraqitur në vitin 2020, në një vit kalendarik të mëpasshëm nga viti kalendarik kur vendimi ka marrë formë të prerë, kishin kaluar më shumë se 10 muaj, kam vlerësuar se duhet të pranohej kërkesa. Qëndrimi im është i bazuar në bindjen e brendshme dhe praktikën e konsoliduar gjyqësore, si dhe vendimi është dhënë para ndryshimit të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i cili parashikonte se të dënuarit mund të përfitonin një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit, ndërsa me ndryshimet që ka pësuar ky ligj me ligjin nr. 81, datë 25.6.2020, është përcaktuar se afati i përfitimit të uljes së dënimit nis jo më parë se 12 muaj nga fillimi i kryerjes së dënimit me burgim, në zbatim të vendimit gjyqësor*

⁴⁸ Referohuni f. 63-64 të aktit.

⁴⁹ 1. Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave, shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19. 2. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve, si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë. 3. Rregullat sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, nuk zbatohen në këto raste: a) Në çështjet administrative, me objekt gjykimit e masave të sigurimit të padisë, në rast se gjykata vlerëson se shqyrtimi pas afatit të përcaktuar në nenin 2, të këtij akti normativ, mund të shkaktojë një dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët; b) Në çështjet familjare, me objekt gjykimi kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë dhe birësimin, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim, si dhe në ato çështje civile në të cilat, përjashtimisht, gjykata vlerëson se shqyrtimi i vonuar i tyre mund të shkaktojë dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët; c) Në çështjet penale, që lidhen me vleftësimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit, caktimin, verifikimin e kushteve e të kriterëve të caktimit dhe nevojat e sigurimit, zëvendësimin, revokimin, bashkimin ose shuarjen e masave të sigurimit të “arrestit në burg” ose të “arrestit në shtëpi”, kur të arrestuarit, të pandehurit ose mbrojtësit e tyre kërkojnë që të vijohet me shqyrtimin e tyre, si dhe në çështjet penale që lidhen me caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”; ç) Në çështjet penale, në të cilat afatet e kohëzgjatjes maksimale të paraburgimit, sipas pikës 6, të nenit 263, të Kodit të Procedurës Penale, mbarojnë gjatë periudhës së pezullimit; d) Në çështjet penale të një natyre urgjente, për shkak të nevojës së sigurimit të provës, sipas nenit 316, të Kodit të Procedurës Penale. Urgjenca vlerësohet nga gjykata që shqyrton çështjen; dh) Në çështjet penale në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, kur ndaj tyre është zbatuar masa e arrestit apo e ndalimit, sipas nenit 15, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur; e) Në çdo çështje tjetër penale ku i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgim, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit.

⁵⁰ Referohuni f. 8-9 të prapësimeve të subjektit, kriterit të aftësive profesionale.

penal të formës së prerë, si dhe ulja e dënimit nuk mund të jepet pa kaluar të paktën 12 muaj nga ulja e fundit e përfiturar [...].

22.4. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar jo bindëse argumentet e dhëna nga subjekti, dhe ka konkluduar se: [...] *Argumenti sipas të cilit, pavarësisht statusit, si të paraburgosurit, ashtu dhe të dënuarit duhet të përfitojnë të njëjtën të drejtë që ligji i jep (në rastin konkret, përfitimi i uljes së dënimit), nuk gjen mbështetje në vetë dispozitat e ligjit. Konkretisht, ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, në nenin 2 bën një dallim të qartë mes këtyre subjekteve, duke parashikuar se: “U nënshtrohen rregullave të këtij ligji të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë...”, ndërsa përfitimet e parashikuara në nenin 63 u referohen vetëm të dënuarve dhe jo të paraburgosurve, siç ka arsyetuar dhe Gjykata e Apelit. Në të njëjtin arsyetim ligjor është edhe qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë⁵¹. Po kështu, rasti i parashikuar në pikën 3, shkronja “e” e aktit normativ të cilit i referohet subjekti, për nga vetë formulimi bën fjalë për çështjet penale kur pozita procedurale e kërkuesit është ajo e të pandehurit dhe jo e të dënuari* ⁵²[...]. Përfundimisht Komisioni e ka transferuar këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

22.5. *Komisioneri Publik*, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni për transferimin e kësaj çështje, vlerëson se vendimi nr.***, datë **.4.2022 nuk duhej të transferohej për inspektim të shkeljeve pranë organit kompetent, në juridiksionin e zakonshëm disiplinor, por duhej të vlerësohej së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

22.5.1. *Komisioneri Publik* çmon se neni 63, pika 1 i ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar përcakton kriteret për të përfiturar ulje dënimi, e konkretisht, janë: (i) një shtetas duhet të jetë i dënuar; (ii) gjatë vuajtjes së dënimit, i dënuari ka respektuar rregullat; (iii) gjatë vuajtjes së dënimit, i dënuari ka pasur pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajnuese.

22.5.2. Në analizë të kësaj dispozite, *Komisioneri Publik* ashtu siç ka arsyetuar edhe Gjykata e Apelit Shkodër, vëren që kushti i parë që mundëson uljen e dënimit është përcaktimi i statusit të kërkuesit, si i dënuar. Sipas kërkesës rezulton se *** ***, ka kërkuar uljen e dënimit për periudhën **.7.2016 deri më **.6.2019, periudhë në të cilën ai ishte në gjendje paraburgimi, pra nuk ishte i dënuar. Shtetasi, konsiderohet i dënuar vetëm në ato raste kur vendimi i dënimit merr formë të prerë. Kërkuesi *** ***, i dënuar konsiderohet që nga data **.6.2019, datë në të cilën është lënë në fuqi vendimi i dënimit të tij, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Pikërisht se nuk kishte statusin e të dënuarit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e formës së prerë, vetëm më datë **.7.2019. Për sa kohë, nuk vërtetohet kushti bazë, qenia e kërkuesit *** *** i dënuar gjatë periudhës për të cilën ai kërkon uljen e dënimit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte rrëzuar kërkesën për ulje dënimi.

22.6. *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i vetëm që ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit *** ***, për “Ulje dënimi”, ka zbatuar gabim ligjin material konkretisht nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, që parashikon se të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit.

22.7. *Komisioneri Publik*, duke mbajtur në konsideratë dhe rëndësinë e arsytimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor⁵³, vlerëson se arsytimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit, ka mangësi në drejtim të njohurive ligjore dhe aftësisë për të interpretuar ligjin dhe analizuar jurisprudencën⁵⁴. Subjekti është në kushtet e mungesës së një

⁵¹ Shihni vendimin nr.00-2021-440, datë 29.6.2021, të Gjykatës së Lartë.

⁵² Referohuni f.49 të vendimit të Komisionit.

⁵³ Shihni vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

⁵⁴ Nuk ka mbajtur në konsideratë vendimin e Gjykatës së Lartë nr. nr.00-2021-440, datë 29.6.2021.

argumentimi ligjor të drejtë, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

23. *Komisioneri Publik* vlerëson se të dhënat e rezultuara në dy rastet (denoncimet) e mësipërme, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit në referim të nenit 61 pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

24. *Denoncim III*⁵⁵, ku denoncuesi ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për korrupsion për një rast të bërë publik dhe në media, pasi sipas tij në kundërshtim me ligjin dhe provat akt ekspertimi ka dënuar me shërbim prove shkaktarin e aksidentit të ndodhur në muajin maj të vitit 2021, ku ka humbur jetën infermierja ***.***., dhe u plagosen 4 pjesëtarët e familjes së saj mes të cilëve dhe një fëmije 2 vjeç. Sipas denoncuesit akuza kishte arritur të provojë se shkak i aksidentit ishte parakalimi i gabuar dhe në konkluzionet përfundimtare kishte kërkuar 11 vite burg. Denoncuesi nuk ka paraqitur dokumentacion.

24.1. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë vendimin nr. **/** datë **.3.2022 me të pandehur shtetasin ***, dhe vendimin nr. ***, datë **.7.2022, për korrigjim gabimi material. Kjo Gjykatë ka informuar⁵⁶ se çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

24.2. Nga aktet e vëna në dispozicion⁵⁷, ka rezultuar se:

- Në datën **.5.2021, ka ndodhur aksidenti automobilistik, ku janë përfshirë disa mjete dhe si pasojë e përplasjes, ka gjetur vdekjen shtetasja ***.***.; shtetasit ***.***., ***.***. dhe i mituri 2 vjeç, kanë pësuar dëmtime në masën mbi 9 ditë, ndërsa shtetasja ***.***. ka pësuar dëmtime të cilat kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit.

- Nga ana e Prokurorisë është kërkuar dënim për kryerjen e veprës penale “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal me 1 vit burgim; 3 vite burgim për kryerjen e veprës penale “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal; 7 vite burgim për kryerjen e veprës penale “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 55 të K. Penal, dënimin e të pandehurit me 11 vite burgim dhe në bazë të nenit 406/1 të K. Pr. Penale, dënimin përfundimisht me 7 vite e 4 muaj burgim, në bazë të nenit 37 të K. Penal ndalimin për drejtimin e mjetit me 3 vite. I pandehuri ka kërkuar të dënohet nën minimumin që parashikon ligji dhe dënimin alternativ.

24.3. Subjekti i rivlerësimit, në vendimin gjyqësor nr. **/**, datë **.3.2022, ndër të tjera ka arsyetuar se:

- Rezulton se provat e administruara janë të mjaftueshme për të konkluduar me fajësinë e të pandehurit ***, me pasojë tre plagosje të lehta, një plagosje e rëndë dhe një vdekje, parashikuar nga neni 290/1/2/3 i K. Penal;

- Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit është arsyetuar se veprat penale bartin rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe çmon se ndaj të pandehurit duhet të aplikohet lloji i dënimit me burg, ndërsa si masë dënimi, për kryerjen e veprës penale “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/1 i K. Penal, 6 muaj burgim; 2 vite burgim për kryerjen e veprës penale “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/2 të Kodit Penal; 5 vite burgim për kryerjen e veprës penale “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290/3 të Kodit Penal. Në aplikim të nenit 55/3 të K. Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e të pandehurit me një dënim të vetëm prej 6 vite burgim dhe në bazë të nenit 406/1 të K. Pr. Penale, duke u dënuar përfundimisht me 4 vite burgim.

⁵⁵ Denoncim nr. *** prot., datë **.10.2023.

⁵⁶ Referohuni shkresës nr. **/** prot., datë *.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Gjykata ka vënë në dispozicion vendimin nr. **/**, datë **.3.2022, dhe vendimin nr. ***, datë **.7.2022, për korrigjim gabimi material.

- I pandehuri plotëson kushtet e posaçme për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në bazë të nenit 59 të K. Penal të evidentuar në gjykim nga mbrojtja (paraqet rrezikshmëri të paket shoqërore pasi është i padënuar me parë, i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen, i pandehuri ka pasur sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprën penale, fakti që marrëdhëniet mes familjes se tij dhe të viktimave të veprës penale janë normalizuar.)

24.4. Me vendimin nr. *** datë ****7.2022**, subjekti i rivlerësimit, ka bërë korrigjimin e gabimit material në vendimin gjyqësor nr. **/** datë ****3.2002**, konkretisht fjalinë: fakti që marrëdhëniet mes familjes se tij dhe të viktimave të veprës penale janë normalizuar, e ka korrigjuar në fakti që marrëdhëniet mes familjes se tij dhe të viktimave të veprës penale janë tentuar të normalizohen.

24.5. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”⁵⁸, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të paraqitur shpjegime dhe prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si në vijim: [...] *nisur nga arsyetimi i subjektit se plotësohen kushtet e posaçme, në referencë të dispozitës materiale 59⁵⁹ të K.P, duket se nuk janë analizuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe të saktë në raport me provat e cituara, pasi: (i) sa i takon rrezikshmërisë së paket⁶⁰, përveç faktit se është i padënuar, nuk ka analizuar faktin se vepra për të cilën është deklaruar fajtor, 290/3 paraqet rrezikshmëri të lartë duke parashikuar një dënim deri në 10 vjet burgim, i pandehuri është hetuar dhe gjykuar në gjendje mase sigurimi arrest në burg;*

(ii) sa i takon rrethanës së posaçme, nuk argumentohet dhe nuk evidentohet se në cilat prova është bazuar subjekti për të arritur në konkluzionin se i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen;

(iii) sa i takon rrethanave të kryerjes së veprës, nuk ka analizuar faktin se nga mënyra e kryerjes së veprës penale pasojat kanë qenë të rënda, me vdekje, dëmtime të rënda dhe me viktimitë të mitur;

(iv) sa i takon sjelljes pas kryerjes së veprës penale, nuk argumentohet dhe nuk evidentohet se në cilat prova është bazuar subjekti për të arritur në konkluzionin se i pandehuri ka pasur sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprën penale. Sipas vendimit nuk rezulton që i pandehuri të ketë shfaqur pendim të thellë për veprën penale;

*(v) sa i takon rrethanave lehtësuese, ajo e normalizimit të marrëdhënieve familjare, të cilës subjekti i është referuar për pezullimin e vendimit, siç rezultoi nga vendimi nr. *** datë ****7.2022** për korrigjim vendimi, ky fakt nuk ekziston, pavarësisht se pas dhënies së vendimit ka bërë korrigjimin e këtij fakti në tentative për ta normalizuar. Për më tepër, nuk argumentohet dhe nuk evidentohet se në cilat prova është bazuar subjekti për të arritur në këtë konkluzion [...].*

24.6. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se⁶¹: [...] *Në vendimin nr. **/** datë ****3.2022** të dhënë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, vlerësoj se në deklarimin fajtor dhe dënimin e shtetasit *****.*****, kam zbatuar ligjin, nenin 290/1/2/3 të K. Penal, 403 e 406 të K. Pr. Penale, si dhe nenin 59 të K. Penal. Vepra penale e parashikuar nga neni 290 i K. Penal është një vepër e cila nuk realizohet me dashje. Nëse do të konsiderohej si vepër penale me dashje, do të konsiderohej si vrasje. Për më tepër që në rastin konkret kam vlerësuar edhe marzhet e dënimit që legjislatori ka parashikuar për këtë*

⁵⁸ Referohuni Rezultateve të hetimit administrativ, faqe 84.

⁵⁹ 1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

⁶⁰ Neni 47/2 i K. P.: Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

⁶¹ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale datë 24.2.2024, faqe 28-29.

vepër penale, ku p.sh. paragrafi i tretë parashikon një minimum dënimi prej 2 vitesh dhe maksimum deri në 10 vjet burgim, duke i lënë gjyqtarit të çështjes caktimin e një dënimi të përshatshëm sipas rrethanave të çështjes apo kryerjes së veprës penale, në varësi të rrezikshmërisë së të pandehurit etj. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë dhe rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, si person i padënuar më parë, gjendjen ekonomike e familjare të tij, qëndrimin e tij rreth akuzës, faktin që është hetuar e gjykuar në kushtet e masës së sigurimit “arrest në burg”, kohën që kishte kaluar nën këtë masë sigurimi, faktin që marrëdhëniet mes tij dhe familjes së dëmtuar ishin drejt normalizimit, plotësoheshin të gjitha kushtet ligjore të parashikuara nga neni 59 i K. Penal [...].

24.7. Komisioni⁶², në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se subjekti ka dhënë sqarime të përgjithshme pa qartësuar në lidhje me çfarë i është konstatuar në rezultatet e hetimit dhe duke iu referuar fakteve që subjekti ka përmendur në vendim, në përfundim të procesit vlerësohet se subjekti në këtë vendim ka cituar shkurtimisht kushtet e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, pa bërë një analizë të mirëfilltë të fakteve e rrethanave që kanë çuar sipas tij në plotësimin e këtyre kushteve. Komisioni ka vendosur transferimin e kësaj çështje, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar ndër të tjera, nuk u vërtetua që këto mangësi në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal të kenë qenë një metodë pune e përsëritur prej subjektit të rivlerësimit.

24.8. Komisioneri Publik, vlerëson se dhe në rastin konkret subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Në këto rrethana të pranuar edhe nga Komisioni, vendimi penal nr. **/**, i vitit 2022, nuk duhej të transferohej për inspektim të shkeljeve pranë organit kompetent, në juridiksionin e zakonshëm disiplinor, por duhej të vlerësohej së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

24.8.1. Në rastin konkret, provohet se subjekti i rivlerësimit, në vendimin e marrë, më së paku, ka treguar mangësi në indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me aspektin e arsytimit ligjor mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit mbi rrethanat të cilat e kanë çuar në vendimmarrjet konkrete.

24.8.2. Po ashtu nga aktet në dosje, konstatohet se dhe vendimi nr. *** datë **.7.2022 i subjektit të rivlerësimit, mbi korrigjimin e gabimit material, i marrë rreth 4 muaj më vonë nga vendimi gjyqësor nr. **/** datë **.3.2022, i cili ka ndryshuar togfjalëshin: janë normalizuar në janë tentuar të normalizohen, duket se nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 114 të K. Pr. Penale / *Ndreqja e gabimeve materiale*, pasi një ndryshim i tillë është substancial, sidomos në kushtet kur vetë subjekti i rivlerësimit e ka analizuar rrethanën e normalizimit të marrëdhënieve mes palëve, për legjitimitimin e aplikimit të nenit 59 të K. Penal.

25. Denoncim IV⁶³, ku denoncuesi pretendon se vendimi nr.*** datë **.3.2021, me palë paditëse *** dhe *** ***, palë e paditur shoqëritë përmbarimore “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv dhe kundërshtim i veprimeve përmbarimore, me të cilin subjekti ka pranuar kërkesë padinë, është me të meta procedurale dhe është dhënë në kundërshtim me ligjin, pasi nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia. Sipas tij në kushtet kur është kërkuar pavlefshmëria e titullit ekzekutiv palë në gjykim duhet të ishte dhe *** Bank e cila ishte palë kreditore.

25.1. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se paditësi *** ** ka qenë kredimarrës tek *** Albania sh.a., sot Banka *** ** sh.a., dhe kjo e fundit ka kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të kontratës së kredisë, dhënë me vendim të gjykatës nr. **, datë **.4.2017 i cili është vënë në ekzekutim nga shoqëria përmbarimore.

25.2. Subjekti me vendimin nr.***, datë **.3.2021, pasi ka arsyetuar se nga shumatorja e shumave të mbajtura palës paditëse për ekzekutimin e titullit ekzekutiv kontrata e kredisë sipas

⁶² Referohuni arsytimit të Komisionit në faqen 64 të vendimit.

⁶³ Shihni denoncim nr. *** prot., datë **.6.2021.

*Urdhrit të Ekzekutimit lëshuar me vendimin nr.** akti datë **.4.2017 del që debitori ka përmbushur detyrimin ndaj palës kreditore,.. në këto kushte bazuar në nenin 609/Iduke i bërë një cilësim të saktë fakteve dhe të veprimeve që lidhen me këtë mosmarrëveshje...., ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv kontratë kredie bankare datë **.6.2015, për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. ** datë **.4.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për shkak se detyrimi është shuar.*

25.3. Pasi çështja është ankimuar nga palët, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. *** datë **.5.2021, ka prishur vendimin nr. ***, datë **.3.2021, dhe ka dërguar çështjen për rigjykim me një trup tjetër gjykues.

25.4. Sa më sipër, Komisioni në aktin⁶⁴ “*Rezultatet e hetimit administrativ...*”, konstaton se, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, bazuar në nenin, 161, 162 e 609 të K. Pr. C. dhe jurisprudenca, është e qartë se gjykimi mbi pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është një gjykim themeli në lidhje me marrëdhënien juridike kreditor-debitor dhe i nënshtrohet gjykimit të zakonshëm kontradiktor. Sa i takon legjitimit të palëve, në pozicionin e paditësit legjitimohet debitori i titullit ekzekutiv i cili godet vlefshmërinë e titullit, legjitimimi aktiv, ndërsa në pozicionin e të paditurit ndodhet kreditori i cili ka legjitimim pasiv.

25.4.1. Padia mbi pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është mjet i mbrojtjes së debitorit gjatë fazës së ekzekutimit, i ndryshëm nga ankimi për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, dhe janë dy gjykime të natyrave të ndryshme si referuar kërkitimit ashtu dhe shkakut ligjor, pavarësisht se mund të jenë objekt i njëkohshëm gjykimi.

25.4.2. Gjykata në këto raste ngarkohet nga ligji që të zbatojë ligjin procedural, në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër, dhe nga ana tjetër të mos lejohet që askush të gjykohet pa iu dhënë mundësia për t’u dëgjuar.

25.4.3. Gjithashtu, Komisionit nga verifikimi në sistemin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në raste të ngjashme⁶⁵ ka mbajtur tjetër qëndrim, duke legjitimuar si palë të paditur kreditorin.

25.5. Në përfundim të hetimit Komisioni, me aktin⁶⁶ “*Rezultatet e hetimit administrativ...*”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se: **(i)** në këtë proces gjyqësor nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia pasi nuk është thirrur kreditori Banka *** *** si palë e paditur, duke sjellë pasoja për këtë të fundit; **(ii)** gjykimi ka cenuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)-së dhe neneve 33 e 42, të Kushtetutës, duke gjykuar pa u dhënë mundësi palëve të dëgjohen.

25.6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se⁶⁷: *[...] Neni 189, 190, 191, 192 K. Pr. Civile ka përcaktuar saktësisht dhe qartësisht veprime procedurale që mund dhe duhet të kryhen nga një person i cili ka interes për tu bërë palë në proces....Neni 193 i K. Pr. C. Civile ka përcaktuar se kur Gjykata çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili ka dijeni për çështjen, e thërret atë. Pra vetë kjo dispozitë ligjore e ka lënë në kompetencën e Gjykatës për të vlerësuar thirrjen apo mos thirrjen e kësaj pale në cilësinë e personit të tretë. Në interpretim të këtij neni kam vlerësuar se nuk ka qenë e domosdoshme thirrja e *** Bank, pasi interesat e saj në këtë proces mbroheshin nga përmbartuesi gjyqësor. I kam kushtuar rëndësi zgjidhjes në themel të çështjes duke vlerësuar*

⁶⁴ Referohuni f. 76-77 të aktit.

⁶⁵ Vendim datë **/10/2019 me nr. çështje ***-***-**-2019, me objekt Deklarimin e pavlefshëm të titujve ekzekutiv fatura tatimore te caktuara, me palë *** *** [Paditës] OSHEE sh.a. [I Paditur]; Vendim datë **/03/2018 me nr. çështje ***-***-**-2017, me objekt Pavlefshmëri titulli ekzekutiv, me palë *** *** [Paditës] kundër: OSHEE sh.a. [I Paditur]; Vendim datë **/03/2017 me nr. çështje ***-***-**-2017, me objekt Deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv Kontratë Kredie bankare nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.1.2011, e lidhur midis: Kreditorit *** sh.a. dhe Kredimarrësve *** ***, *** ***, dorëzanës *** *** dhe *** *** me objekt Pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv Kontrate Kredie Bankare nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.1.2011 etj., me palë *** *** [Paditës] Kundër: Banka *** *** sha [I Paditur].

⁶⁶ Referohuni f. 63-64 të aktit.

⁶⁷ Referohuni propësimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale datë 24.2.2024, faqe 19.

*në dhënien e një vendimi të drejtë për palët. ...Për sa më sipër vlerësoj se zgjidhja ime ka qenë e drejtë pasi dhe pas rishqyrtimit të kësaj çështje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë edhe pse është thirrur në proces në cilësinë e palës së tretë, Banka *** Sha Albania, në zbatim të detyrave të lëna Gjykata e Apelit, vendimmarrja e Gjykatës me vendim nr.***, datë **.04.2022 është në thelb e njëjtë me zgjidhjen e dhënë nga ana ime në vendimin nr.***, datë **.03.2021 [...].*

25.7. Komisioni i ka vlerësuar jo bindëse argumentet e dhëna nga subjekti, dhe ka arritur në përfundimin se: [...] *si edhe Apeli ka arsyetuar qartë parregullsinë e ndërgjyqësisë dhe se banka duhet të jetë palë në proces. Po kështu nuk qëndron as argumenti se neni 193 i lë në kompetencë Gjykatës për të vlerësuar thirrjen apo mosthirrjen e kësaj pale në cilësinë e personit të tretë, pasi, siç rezultoi, pala paditëse gjatë rigjykimit ka ndryshuar objektin e padisë dhe nuk pretendon më për pavlefshmëri titulli ekzekutiv, por ngre pretendime mbi veprimet e përmbaruesit⁶⁸ [...].*

25.8. Komisioneri Publik vlerëson sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Apelit Shkodër, se në këtë proces gjyqësor nuk është i rregullt legjitimimi pasiv i palëve ndërgjyqëse, pasi janë thirrur në proces me cilësinë e palës së paditur përmbaruesi gjyqësor që ka filluar ekzekutimin (shoqëria përmbarimore gjyqësore private “****” sh.p.k.) dhe përmbaruesi që po ekzekuton titullin (shoqëria përmbarimore gjyqësore private “**** *** ****” sh.p.k.), por nuk është thirrur si palë në proces dhe kreditori që ka iniciuar procesin përmbarimor. Ky i fundit nuk është domosdoshmërisht palë në proceset që kanë për objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore sipas nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, por duhet të thirret me cilësinë e palës së paditur në paditë me objekt pavlefshmëri të titullit ekzekutiv.

25.9. Në këtë rast nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia dhe gjykimi në shkallë të parë është në shkelje të rregullave që disjunojnë ndërgjyqësinë, pasi përveç shoqërive përmbarimore private, palë në proces duhet të ishte edhe Banka *** Albania sh. a. (sot Banka *** *** sh. a.), e cila është kreditore në këtë procedurë përmbarimore dhe subjekt që tërheq interesa, dhe për të drejta nga pretendimet për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv.

25.10. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas kërkesave ligjore, si dhe ka treguar mangësi në kriterin e cilësisë së analizës dhe arsyetimit ligjor për të marrë vendime gjyqësore, kriteret të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

26. Denoncim V⁶⁹, ku denoncuesi ngre pretendime për çështjen gjyqësore civile, me palë paditëse *** dhe *** *** dhe palë e paditur *** Bank sh.a. etj., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute kontratë hipotekimi, konstatimin e pavlefshmërie absolute kontratë kredie dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, por nuk ka paraqitur dokumentacion.

26.1. Sipas denoncuesit, kredimarrësit dhe hipotekuesit *** *** dhe *** ***, kanë lidhur kontratën e kredisë dhe të hipotekës me nr. *** rep. nr. *** kol., datë **.5.2007, duke lënë si garanci për shlyerjen e detyrimit, pasurinë “Apartament” me sipërfaqe 56.1 m², nr. pasurie ***/+*_* , zk.***, vol.** , fq.***, ndodhur në *** Lezhë. Gjatë veprimeve përmbarimore ka rezultuar se në këtë apartament ishte bërë një shtesë dhe sipas kontratës së kredisë dhe kjo shtesë në përfundim të veprimeve përmbarimore i ka kaluar në pronësi bankës. Më pas shtetasit *** dhe *** *** me datë **.10.2007 kanë paraqitur padi për pavlefshmëri absolute të kontratave me pretendimin se pasuria ka qenë në bashkëpronësi të dyve dhe të prindërve *** dhe *** *** dhe subjekti i rivlerësimit me vendim nr. ***, datë **.5.2018 e ka pranuar padinë.

26.2. Denoncuesi pretendon se subjekti në mënyrë të gabuar me vendimin nr. *** datë **.5.2018 ka pranuar padinë, pasi sipas tij, paditësit nuk legjitimohen për ngritjen e kësaj padie duke mos qenë bashkëpronarë. Po ashtu edhe për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore

⁶⁸ Referohuni f. 58 të vendimit të Komisionit.

⁶⁹ Shihni denoncim nr. *** prot., datë **.8.2018.

pasi kjo e drejtë ishte parashkuar, subjekti është shprehur përtej asaj që është kërkuar, në kundërshtim me nenin 6 të K. Pr. C.

26.3. Nga përmbajtja e vendimit nr. ** datë **.5.2018 vërehet se është paraqitur kërkesë për shtim objekti padie e cila është pranuar. Subjekti ka analizuar legjislacionin, ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 për legalizimet, Kodit Civil dhe Kodit të Familjes etj. dhe ka arsyetuar ndër të tjera se: *Lidhur me llojin e pavlefshmërisë, gjykata në mbështetje të nenit 92 dhe 94 të Kodit që përcaktojnë përkatësisht rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të veprimit juridik vlerëson se nuk jemi para asnjërit prej rasteve të pavlefshmërisë relative për kryerjen e një veprimi juridik, por para kryerjes së veprimit juridik në kundërshtim me dispozitë urdhëruese të ligjit përkatësisht nenet 208 të Kodit Civil dhe 234 të Kodit të Familjes.*

26.4. Në lidhje me anulimin e veprimeve përbarimore ka arsyetuar se: Duke vlerësuar se titulli ekzekutiv *kontratë e kredisë bankare dhe hipotekës nr.*** rep. nr.*** kol., datë **.5.2007 është veprim juridik absolutisht i pavlefshëm për faktin se nuk është marrë pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve për lënien në hipotekë të pasurisë në bashkëpronësi, provohet se edhe gjatë procedurës përbarimore paditësit të cilët rezultojnë pronarë të pasurisë objekt i procedurës përbarimore, nëpërmjet mosnjofimit të veprimeve përbarimore, u është cenuar e drejta e ankimit dhe ajo e aksesit në gjykatë, për këtë arsye Gjykata çmon se gjithë procedura përbarimore që prej momentit të fillimit të ekzekutimit vullnetar të titullit ekzekutiv dhe deri në përfundim të saj, është një procedurë e pavlefshme.*

26.5. Pas ankimit të çështjes nga denoncuesi, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ** datë **.3.2021, ka ndryshuar vendimin nr. ***, datë **.5.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke rrëzuar kërkesë-padinë .

26.6. Në përfundim të hetimit Komisioni, me aktin⁷⁰ “Rezultatet e hetimit administrativ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se subjekti i rivlerësimit në këtë proces gjyqësor gjyqësor ka vepruar në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural pasi : **(i)** Paditësit nuk kanë një të drejtë të ligjshme për të mbrojtur në këtë proces gjyqësor civil, duke qenë se nuk kanë qenë palë pjesëmarrëse si dhe nuk vërtetohet as që të jenë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme të hipotekuar; **(ii)** Paditësit nuk kanë ligjitimim aktiv për ngritjen e kërkesë padisë për të kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së hipotekimit dhe për kërkimet e tjera të parashtruara në kërkesëpadi që kanë të bëjnë me procedurat përbarimore.

26.7. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se⁷¹: [...] Në kohën e lidhjes së kontratës është vënë në garanci një pasuri me sipërfaqe 56.1 m², por kredimarrësi kishte ndërtuar dhe më pas legalizuar shtesën e cila ishte 51.9 m² dhe në total pasuria shkon në 108 m². Pikërisht këtu qëndron konflikti pasi duke mos shlyer kredinë, Banka në momentin e kryerjes së veprimeve ka kërkuar vënie në sekuestro të të gjithë sipërfaqes totale të kësaj pasurie, gjendjen aktuale të saj sot... në total 108 m², si dhe është vendosur kalimi në pronësi të *** Bank sh.a. Pra edhe pse është vendosur në hipotekë një pasuri me sipërfaqe totale 56.1 m² veprimet e përbaruesit janë shtrirë mbi të gjithë pasurinë e konkretisht edhe mbi pasurinë me sipërfaqe 59.1 m², pasuri në të cilën paditësit janë bashkëpronarë të saj, pasi kjo shtesë është krijuar pas legalizimit të saj dhe ata përfitojnë nga ky ligj. Ky ka qenë dhe fakti që unë kam legjitimuar paditësit në këtë kërkim dhe ju kam dhënë të drejtë pasi kam vlerësuar se nga Banka nëpërmjet përbaruesit ju ishte marrë pasuria prej 59.1 m², e cila nuk ishte vënë në hipotekë në momentin e marrjes së kredisë. Pikërisht për këtë shkak në arsyetimin e vendimit i jam referuar ligjit për legalizimin. Në vendimmarrjen e saj Gjykata e Apelit, nuk është shprehur për të gjitha kërkimet e palëve, por këtë gjë nuk mund ta komentoj unë pasi është e drejta e palëve t’i drejtohen një gjykate më të lartë, e cila mund të më japë të drejtë dhe mua pas vendimmarrjes saj. Nuk kam informacion nëse kjo çështje është ankimuar në Gjykatën e Lartë [...].

⁷⁰ Referohuni f. 82 të aktit.

⁷¹ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale datë 24.2.2024, faqe 24.

26.8. Sa i përket denoncimit për zvarritjen e shpalljes së vendimit, subjekti i ka vënë Komisionit në dispozicion shkresën nr. ***/* prot., datë **.1.2023 për njoftim ankimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe vendimin nr. *** prot., datë **.1.2023 sipas të cilës është vendosur arkivimi i ankesës pas shqyrtimit fillestar, duke mos u konsideruar shkelje.

26.9. Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *Subjekti i është referuar edhe ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin”, pasi siç dhe rezultoi, përveç hipotekimit mbi sipërfaqen e regjistruar prej 56.1 m², është vënë sekuestro edhe mbi shtesën me sipërfaqe prej 59.1 m², ndërsa Gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit nuk është shprehur në lidhje me këtë çështje, por vetëm sa i takon sipërfaqes së regjistruar prej 56.1 m². Për rrjedhojë, për sa kohë që subjekti sipas logjikës së tij ka bërë interpretimin e aplikimit të ligjit, duke e arsyetuar qëndrimin e tij dhe i ka dhënë zgjidhje themelit të çështjes, ndonëse ndryshe nga ai bërë nga Gjykata e Apelit, nga ana e Komisionit vlerësohet se në këtë rast denoncimi në thelb ka të bëjë me themelin e çështjes, ndërsa nuk evidentohet ndonjë parregullsi nga ana e subjektit*⁷² [...].

26.10. Ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, *Komisioneri Publik* vlerëson të konstatojë se në këtë rast Gjykata e Apelit Shkodër ka gjetur se vendimi nr.*** datë **.5.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është i pabazuar në ligj e në prova.

26.10.1. Sikundër është arsyetuar në vendimin e gjykatës kontrolluese (apeli), paditësit *** dhe *** nuk kanë një të drejtë të ligjshme për të mbrojtur në këtë proces gjyqësor civil. Në kontratën e kredisë dhe të hipotekimit që ata kontestojnë me kërkesëpadi, rezulton se ata nuk kanë qenë palë pjesëmarrëse e nuk vërtetohet as që të jenë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme të hipotekuar në favor të garantimit të kthimit të shumës së dhënë kredi, pasi certifikata e pronësisë së pasurisë së paluajtshme të vendosur si garanci hipotekore është lëshuar në emër të të paditurit *** më datë **.8.2006.

26.11. Në përfundim, *Komisioneri Publik* vlerëson se arsyetimi i vendimit të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, tregojnë për mangësi sipas përcaktimit të ligjit 96/2016, neni 72, “*Aftësia profesionale e gjyqtarit*”, pika 2 e tij aftësisë për të interpretuar ligjin, si dhe pika 3 në aspektin e cilësisë së analizës dhe duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e kriterit profesional.

27. Denoncim VI⁷³, i përcjellë nga Komisionerët Publikë, ku denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim penal në kundërshtim me ligjin, pasi sipas tij ka dënuar shtetasin *** nën minimumin e parashikuar nga ligji. Bashkëngjitur, denoncuesi, ka paraqitur pjesë nga vendimi nr. *** (**/2023-***), datë **.6.2023, dhënë nga subjekti, ku duket se i pandehuri ***, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1, “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, është deklaruar fajtor për këtë vepër dhe është dënuar me 3 vite burgim.

27.1. Komisioni në vlerësim të denoncimit ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë⁷⁴, dosjen penale nr. ***, datë **.6.2023, dosjen penale me objekt *dërgimin në gjyq*, nr. ***, datë **.10.2022, si dhe fashikullin penal nr. ***/2021 të Prokurorisë Lezhë. Nga aktet e dosjes të çështjes gjyqësore me nr. ***, datë **.06.2023, trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton⁷⁵ se:

27.1.1. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë **.6.2023, prokurori ka dhënë verbalisht konkluzionet përfundimtare, duke kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit ***, në bazë të nenit 283/1 të K. Penal dhe dënimit të tij me 5 vite burgim. Në aplikim të nenit 406 uljen me 1/3 dhe dënimit përfundimisht me 3 vite e 4 muaj, të aplikohet neni 59 duke vënë në periudhe prove për kohën e mbetur.

27.1.2. Sipas konkluzioneve përfundimtare të mbrojtësit, në mënyrë të përmbledhur, është pretenduar se: (i) akuza e ngritur është e pa drejtë dhe e pa mbështetur në prova si dhe është

⁷² Referohuni fq. 62 të vendimit të Komisionit.

⁷³ Denoncimi nr. *** prot., datë **.8.2023.

⁷⁴ Referohuni shkresës nr. ***/* prot., datë *.12.2023 të GJSHPJP Lezhë në dosjen e Komisionit.

⁷⁵ Referohuni rezultateve të hetimit administrativ, faqe 57-59.

kërkuar pushimi i çështjes, duke pretenduar në thelb që sasia është për përdorim vetjak; (ii) nga ana tjetër është kërkuar se në rast se gjykata ka krijuar bindjen e brendshme se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, të marrë në konsideratë rrethanat si: i mbrojturi është i padënuar me parë, ka kërkuar gjykim të shkurtuar, pranon faktin që lënda e gjetur kalon dozën ditore për përdorim vetjak, por asnjëherë nuk ka qenë shpërndarës, shitës i lëndës narkotike, qëndrimi i tij korrekt gjatë hetimit, dënimi i tij do të ndikojë negativisht si në jetën shoqërore ekonomike dhe psikologjike të familjes së tij; (iii) Për sa i përket masës së dënimit është kërkuar që në aplikim të nenit 53 të K. Penal, të ulet dënimi nën kufijtë e parashikuar nga ligji, etj.

27.1.3. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. *** datë **.6.2023, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit ***,***, për veprën penale të nenit 283/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim, në bazë të nenit 406/1 të K. Pr. P., uljen e 1/3 të dënimit dhe dënimin përfundimisht me 2 vite burgim etj. Ky vendim është i formës së prerë. Subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka arsyetuar se: [...] Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ***, ***, e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kështu, rezulton e provuar se i pandehuri ***, ***, në kundërshtim me ligjin në formën e mbajtjes për shitje të lëndës narkotike, duke mos qenë përdorues, nga provat e administruara rezulton se i pandehuri ka patur qese që brenda kishin lëndë narkotike;

- I pandehuri nuk ka bashkëpunuar me organin e procedimit; marrëdhënia juridike që kjo veprë prek ose cenon, janë marrëdhëniet juridike me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

- Bazuar në nenin 49 të K. Penal, Gjykata çmon si rrethanë lehtësuese se i pandehuri nuk është përsëritës, ai rezulton i pa dënuar më parë;

- Lidhur me masën e dënimit me burgim.....një masë dënimi nën minimumin që parashikon vepra penale me 3 vjet burgim, duke marrë në konsideratë moshën e tij që mos t'i shkaktojë traumë të rëndë në të ardhmen, në bazë të nenit 53 të K. Penal.

- Në lidhje me kërkesën për pezullimin e dënimit me burgim, gjykata vlerëson se nga i pandehuri nuk është shfaqur pendesë për veprën penale të kryer dhe nuk ka bashkëpunuar me organin e akuzës. [...]

27.2. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”⁷⁶, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] në përfundim të hetimit administrativ rezulton se subjekti ka dhënë një dënim nën minimumin e parashikuar nga vepra penale në aplikim të nenit 53 të K.P. Por, duke u nisur nga aktet e dosjeve, arsyetimi i vendimit si dhe neni 53, “Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji”, aplikimi i të cilit kërkon plotësimin e disa kërkesave⁷⁷, duket se vendimi i subjektit nuk është i bazuar në ligj dhe provat e administruara, si dhe është në kundërshtim me vetë arsyetimin e tij pasi:

(i) nuk është arsyetuar pse rasti objekt gjykimi kualifikohet si rast i veçantë. Argumenti i moshës është i pa bazë pasi i pandehuri as nuk është minoreni as nuk është në moshë të thyer;

(ii) vepra penale nuk paraqet rrezikshmëri të pakët, por të lartë ashtu siç dhe vetë subjekti ka arsyetuar;

(iii) nuk arsyetohet dhe provohet ekzistenca e të paktën dy nga rrethanat lehtësuese sipas nenit 48, 49 të K. Penal;

⁷⁶ Referohuni Rezultateve të hetimit administrativ, faqe 58-59.

⁷⁷ **Neni 53 i K. P.:** Gjykata, në raste të veçanta, kur çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të paktë dhe janë të pranishme disa nga rrethanat lehtësuese, dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese ka të drejtë të caktojë një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse;

Neni 48 i K. P.: Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë: a) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore; b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër; c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit; ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë; d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale; e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar...

Neni 49 i K.P.: Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethanat të tjera për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

(iv) i pandehuri nuk ka treguar pendim të thellë, përkundrazi dhe vetë subjekti ka arsyetuar se nga i pandehuri nuk është shfaqur pendesë për veprën penale të kryer dhe nuk ka bashkëpunuar me organin e akuzës [...].

27.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se⁷⁸: [...] Lidhur me këtë vendim kam për të sqaruar se kemi të bëjmë me një vendim të FORMËS SË PRERË në të cilin është aplikuar neni 53 i K. Penal ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji. Qëllimi i dënimit penal nuk është vetëm ndëshkimi, por njëkohësisht edhe edukimi i autorit të veprës penale. I pandehuri ***. ***. është hetuar dhe gjykuar nën masën e sigurimit “arrest në burg” që nga data **.10.2021 deri në datën **.4.2022, kur nga gjykata e shkallës së parë Lezhë është vendosur masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, masë me të cilën i pandehuri është gjykuar nga unë si relator i çështjes. Gjatë gjithë periudhës së gjykimit i pandehuri nuk i është shmangur hetimit nuk ka thyer kushtet e sigurisë së arrestit në shtëpi, nuk ka paraqitur rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi nuk ka qenë i dënuar më parë, nuk ka patur asnjë rrethanë rënduese, masa e lëndës narkotike e sekuestruar në cilësinë e provës ka qenë shumë e vogël, sapo ka kaluar kufirin e përdorimit vetjak. Në tërësinë e të gjitha rrethanave kam vlerësuar se jemi përpara rrethanave të parashikuara nga neni 53 i K. Penal, i cili ka parashikuar se aplikimi i këtij neni ka të bëjë me rrezikshmërinë e pakët të të pandehurit si dhe me praninë e disa rrethanave lehtësuese si dhe faktin e mospasjes së asnjë rrethane rënduese. Gjithashtu kam vlerësuar se duhet të aplikohet ky nen dhe për faktin se gjatë gjithë kohës së hetimit e gjykimit ai ka qenë në kushtet e masës sigurimit “arrest në burg” e më pas “arrest në shtëpi”. Në këtë vendimmarrje pavarësisht se për shkak të ngarkesës së lartë mund të çëdojë në arsyetimin e vendimit sa i përket kushteve të aplikimit të nenit 53 të K. Penal, qëllimi i të gjithë arsyetimit është vlerësimi se pse nuk është pranuar kërkesa e prokurorit për mos aplikimin e nenit 59 të K. Penal. Duke qenë se në fokus të arsyetimit i kam kushtuar rëndësi faktit të mospranimit të kërkesës së prokurorit për aplikimin e nenit 59 të K. Penal, nuk i kam kushtuar shumë rëndësi arsyetimit të kushteve të aplikimit të nenit 53 të K. Penal, pasi kam vlerësuar se këto kushte plotësoheshin nga i pandehuri. Kemi të bëjmë me një vendim të dakordësuar nga të gjitha palët, ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim, pra një vendim i FORMËS SË PRERË për dhënien e të cilit kam gjykuar krahas provave dhe bindjes time së brendshme të krijuar në këtë gjykim.[...]

27.4. Komisioni, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka vlerësuar se subjekti ka dhënë mjaftueshëm argumente për të justifikuar aplikimin e nenit 53 të K. Penal, por, sikurse dhe ai vetë e pranon, në rastin konkret ai duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në arsyetimin e vendimit. Nga ana tjetër, vlerësimi i aplikimit të nenit 53 është një e drejtë vendimmarrjeje nga ana e subjektit si gjyqtar, bazuar në rrethanat konkrete në momentin e vlerësimit, në bazë të bindjes së tij të brendshme dhe Komisioni, në bazë të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, nuk mund të gjykojë vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka vlerësuar që rasti në fjalë, kur është aplikuar neni 53 i K. Penal, është rast i vetëm dhe mangësitë e konstatuara në arsyetimin e vendimit në rastin konkret në vetvete nuk mund të konsiderohen si penalizuese për efekt të procesit të rivlerësimit, pasi janë pa ndonjë pasojë dhe nuk tregojnë vullnetin e subjektit për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit.

27.5. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, se aplikimi i nenit 53 të K. Penal është një rast i vetëm, vëren se mangësitë e konstatuara në drejtim të arsyetimit ligjor të vendimit të konstatuara dhe nga vetë Komisioni, nuk përbëjnë një rast të vetëm dhe në vlerësimin e Komisionerit Publik, duhen vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera në drejtim të nën indikatorëve të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit, përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

27.5.1. Po ashtu, në raport me aplikimin e nenit 53 të K. Penal/ Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, arsyetimi i vendimit të subjektit të rivlerësimit bie ndesh me sa

⁷⁸ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, datë 24.2.2024, faqe 5-6.

parashikuar në këtë dispozitë në të cilën shprehimisht thuhet se “*dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese.*” Përkundër sa më lart, vetë subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij ka arsyetuar se “*i pandehuri nuk ka bashkëpunuar me organin e procedimit; marrëdhënia juridike që kjo vepër prek ose cenon, janë marrëdhëniet juridike me rrezikshmëri të lartë shoqërore*”.

28. *Denoncim VII*, ku denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar fisin e ***, me vendimin datë **.3.2021 për pushimin e çështjes së shtetasit *** ***, me vendimin datë **.9.2018 për shtetasit *** *** dhe *** *** ka dhënë dënime të ulëta, me vendimin datë **.3.2018 për shtetasin *** *** ka miratuar marrëveshjen e fajësisë në kundërshtim me ligjin si dhe ka pezulluar vendimin, edhe pse kanë qenë të dënuar penalisht.

28.1. Komisioni në vlerësim të denoncimit, ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dosjet gjyqësore të vendimeve nr. ***, datë **.3.2021; vendimit nr. ***, datë *.9.2018 dhe vendimit nr. ***, datë **.3.2018.

28.2. *Lidhur me dosjen gjyqësore të vendimit nr. *** datë **.3.2021*, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se Prokuroria e Posaçme në datë *.1.2020 me miratimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtares së seancës paraprake) ka paraqitur për gjykim çështjen penale me të pandehur *** *** etj. të akuzuar për veprat penale “*Falsifikimi i dokumenteve*” në bashkëpunim, “*Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve*”, në bashkëpunim, “*Shpërdorimi i tokës*”, në bashkëpunim, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga nenet 186/2, 190/2, 199, 25 dhe 287 pika “a” të Kodit Penal. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendim datë **.9.2020, ndër të tjera, ka vendosur: *Shpalljen e moskompetencës lëndore të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit *** *** dhe dërgimin e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si gjykatë kompetente...*

28.2.1. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes, mbrojtja ka kërkuar deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** ***. Subjekti i rivlerësimit, me vendim nr. *** datë **.3.2021, bazuar në nenet 148/1 të Kushtetutës dhe nenet 112, 377, 379, 384, 387 e vijues të Kodit të Pr. Penale, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit *** ***.

28.2.2. Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit administrativ ...*”⁷⁹, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016 i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] (i) *mbetet e paqartë përse subjekti ka arsyetuar se çështja objekt shqyrtimi është disponimi i gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq; (ii) mbetet e paqartë nëse prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes apo tërheqjen e akuzës, si dhe arsyet, pasi në vendim nuk pasqyrohet përmbajtja e kësaj kërkesë; (iii) subjekti i referohet parashikimit të nenit 377 të K. Pr. P., por nuk bën asnjë citim, analizë dhe arsyetim mbi gjendjen që janë provat mbi të cilat del se duhet të pushohet çështja, siç e kërkon kjo dispozitë; (iv) mbetet e paqartë dhe e paarsyetuar së cilës prej rasteve të parashikuara nga neni 328⁸⁰ të K. Pr. P. (që i referohet nenit 387 i K.Pr.P.), i referohet subjekti kur shprehet se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë; (v) mbetet e paqartë se cilit vendim/e të Gjykatës së Lartë, i referohet subjekti në vendim [...].*

28.2.3. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, në lidhje me konstatimin e parë të Komisionit, në parashtrimet e dërguara me email, datë 4.3.2024, ka deklaruar se: [...] *ka një lapsus në paragrafin e katërt, ku jam shprehur se “... në çështjen objekt shqyrtimi jemi para disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq...”, kur në fakt,*

⁷⁹ Referohuni Rezultateve të hetimit administrativ, faqe 69.

⁸⁰ Neni 328 i K. Pr. P.: 1. *Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimat nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.*

për shkak të mungesës së fjalës “NUK” ndryshon edhe kuptimi i fjalisë. Nga arsyetimi në tërësi i këtij vendimi del e qartë situata që nga ana ime është vijuar me shqyrtimin e themelit të çështjes [...]

28.2.3.1. Në lidhje me konstatimet e tjera, subjekti në parashtrimet e tij⁸¹ i është përmbajtur të njëjtit arsyetim dhe logjikë me atë të bërë në arsyetimin e vendimit, pra që veprat penale të regjistruara në ngarkim të të pandehurit ***. ***. nuk provohet se janë kryer nga ai. Subjekti ka bërë analizë të nenit 377 të K. Pr. Penale dhe, në bazë të këtij neni, pasi janë shqyrtuar të gjitha provat, parashtron se prokurori ka tërhequr akuzën duke kërkuar pushimin, e në këtë rast gjykata duke mos pasur një bindje të ndryshme nga prokurori mbi mënyrën e zgjidhjen e çështjes, referuar mungesës së provave ndaj këtij të pandehuri dhe bindjes së tij të brendshme, ka vendosur pushimin e çështjes penale. Subjekti deklaroi se gjatë gjithë arsyetimit të vendimit nuk i është referuar ndonjë vendimi konkret të Gjykatës së Lartë, por në tërësi praktikës dhe jurisprudencës së saj dhe i është referuar vetëm ligjit, K. Pr. Penale, nenit 377 dhe 387/1, germa dh) të tij.

28.2.4. Komisioni, ka arritur në përfundimin⁸² se: [...] *sa i takon konstatimit të parë, pranohet nga subjekti se ka pasur një lapsus, fakt që nga Komisioni vlerësohet se nuk ka sjellë ndonjë pasojë. Sa i takon analizës dhe arsyetimit mbi gjendjen që janë provat, subjekti ndalet te fakti se janë shqyrtuar të gjitha provat dhe se bindja e gjykatës ka qenë e njëjtë me atë të prokurorit. Në lidhje me këtë deklaram, Komisioni nuk mund të fajësojë subjektin sa i takon bindjes së tij, ndonëse vlerëson se duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në renditjen e fakteve dhe provave mbi të cilat është krijuar kjo bindje. Siç rezultoi, i pandehuri duke mos qenë dakord me vendimin e subjektit, e ka ankimuar atë duke kërkuar pafajësi, për rrjedhojë nuk mund të konkludohet se subjekti ka mbajtur qëndrim favorizues, sikurse pretendohet në denoncim. Sa i takon çështjes nëse duhet të vendoste pushimin apo pafajësinë e të pandehurit, sipas pretendimeve të palëve, bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këta të cilët janë në kompetencë të një gjykate më të lartë, që siç rezulton çështja pritet të shqyrtohet në Apel [...].*

28.3. Lidhur me dosjen penale të vendimin nr. *** datë **.9.2018, nga shqyrtimi i të cilës rezulton se me vendimin nr. *** datë **.5.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, (me gjyqtar *** ***), në seancë paraprake ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit *** *** për veprat penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” (2 herë) dhe “Kanosje” të parashikuara nga neni 278/1, 278/1 dhe 84 të Kodit Penal, dhe në ngarkim të të pandehurit *** *** për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” të parashikuara nga neni 278/1/2 të Kodit Penal.

28.3.1. Në vendimin nr. *** datë **.9.2018, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit dhe të pandehur: *** ***, i akuzuar për veprat penale të “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” dhe “Kanosja” të parashikuara nga nenet 278/1, 278/1 dhe 84 të K. Penal dhe *** ***, i akuzuar për veprën penale të “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal, vërehet se prokurori ka kërkuar: (i) pushimin e akuzës për veprën penale të “Kanosja” neni 84 K. P.; *deklarimin fajtor të *** *** për veprën penale Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak*, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim; *deklarimin fajtor të *** *** për veprën penale Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak*, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim; në aplikim te neneve 55 të K.P dhe 406 të K. Pr. P. dënimin përfundimisht me 3 vjet burgim; (ii) *deklarimin fajtor të *** *** për veprën penale Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak*, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet

⁸¹ Referohuni prapësisht të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale datë 24.2.2024, faqe 12-14.

⁸² Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 53 të vendimit.

burgim; në aplikim të nenit 406 dënimin përfundimisht me 3 vjet burgim. Mbrojtja ka kërkuar dënimin në minimum që parashikojnë veprat dhe aplikimin e nenit 59 të K. P.

28.3.2. Në përfundim subjekti i rivlerësimit bazuar në nenet 278/1, 84 të Kodit Penal, nenet 47, 48, 49 të Kodit Penal, nenet 406/1, 284, 286, 379 dhe 387 të Kodit të Pr. Penale, ka vendosur sipas pikave: **1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit *** *** për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim; **2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit *** *** për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim; **3.** Në aplikim të nenit 55 të K. Penal bashkimin e dënimeve për të pandehurin *** *** duke e dënuar me një dënim të vetëm me 4 vjet e 6 muaj burgim; **4.** Në aplikim të nenit 406 të K. Pr. P. të ulë 1/3 e dënimit të caktuar dhe përfundimisht i pandehuri *** *** të dënohet me 3 vite burgim; **5.** Pushimin e akuzës për veprën penale të “Kanosja” të parashikuar nga neni 84 K. Penal; **7.** Deklarimin fajtor të të pandehurit *** *** për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim; **8.** Deklarimin fajtor të të pandehurit *** *** për veprën penale Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga neni 278/2 të K. Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim; **9.** Në aplikim të nenit 55 të K. Penal bashkimin e dënimeve për të pandehurin *** *** duke e dënuar me një dënim të vetëm me 3 vite burgim; **10.** Në aplikim të nenit 406 të K. Pr. P. të ulë 1/3 e dënimit të caktuar dhe përfundimisht i pandehuri *** *** të dënohet me 2 vite burgim.

28.3.3. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”⁸³, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] duket se në referim të nenit 383 të K.Pr.K, konstatohen mangësi në përpilimin e vendimit, parashtrimin e fakteve, arsyetimin e vendimit, referimin e dispozitave ligjore si dhe aplikimin e një mase dënimi më të lartë sesa parashikimi dispozitës ligjore përkatëse, pasi: (i) në pjesën hyrëse nuk gjejnë pasqyrim të plotë dhe të saktë akuzat dhe bazat ligjore pasi për të pandehurin *** *** ka referuar dy herë të njëjtën akuzë. Ndërsa për të pandehurin *** *** ka referuar vetëm akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 K.P. dhe jo për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 K.P; (ii) në pjesën përshkruese arsyetuese nuk ka analizuar veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i K.P, ndërsa për një të pandehur as nuk e citon atë; (iii) në dispozitiv në pikën 2, në dhënien e dënimit ndaj të pandehurit *** ***, nëse subjekti i referohet paragrafit të dytë të nenit 278, ka caktuar një masë dënimi me të lartë se ajo e përcaktuar nga kjo dispozitë, pra 3 vjet burgim [...].

28.3.4. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, në lidhje me konstatimin e Komisionit për të pandehurin *** ***, në parashtrimet e dërguara me email, datë 4.3.2024 ka deklaruar se: [...] në pjesën hyrëse të vendimit nr.***, datë **.9.2018 ka vetëm një lapsus, konkretisht në pjesën e akuzës për këtë të pandehur, e cila duhet të ishte neni 278/1/2 i Kodit Penal, pra mungon /2. Ky lapsus nuk passjell asnjë pasojë në zgjidhjen e çështjes [...].

28.3.5. Në lidhje me konstatimet e tjera, subjekti në parashtrimet e tij⁸⁴ ka deklaruar se: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykimin e të pandehurit ***. ***, duke e akuzuar atë dy herë për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” dhe “Kanosja”, të parashikuara nga nenet 278/1, 278/1 dhe 84 të Kodit Penal. Është akuzuar dy herë për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”. Në analizë të rrethanave të pasqyruara në vendimin penal të arsyetuar rezulton se i pandehuri ***. ***. është akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 278/1 e 84 të Kodit Penal për ngjarjen e datës **.5.2017 dhe për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal në ngjarjen e datës **.10.2017 (ngjarje e cila përkon me arrestimin e tij). Në asnjë rresht të këtij vendimi nuk arsyetohet e relatohet për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, por gjatë gjithë vendimit i referohem nenit 278/1

⁸³ Referohuni Rezultateve të hetimit administrativ, faqe 71.

⁸⁴ Referohuni propësimëve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, datë 24.2.2024, faqe 15-16.

të Kodit Penal, për të cilin është deklaruar fajtor. Në vendim është e shënuar se i pandehuri ***. ***. e ka kryer plotësisht veprën penale të mësipërme dy herë dhe ndryshimi në masën e dënimit me të pandehurin tjetër, i cili është gjykuar dhe deklaruar fajtor në të njëjtin procedim penal, konkretisht i pandehuri ***. ***., është sepse ky i pandehur është akuzuar vetëm një herë për veprën penale, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe përfundimisht është dënuar me 2 vite burgim. Pra, në asnjë pikë të dispozitivit të këtij vendimi nuk është shënuar neni 278/2 i Kodit Penal.

28.3.6. Komisioni, ka arritur në përfundimin⁸⁵ se [...] *pretendimet e subjektit se në vendim ka pasqyruar saktë akuzën për të pandehurin *** ***, pasi ai është akuzuar dy herë për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe nuk ka pasur akuzë për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, vlerësohet se qëndrojnë. Ndërsa sa i takon pretendimeve në lidhje me të pandehurin *** ***, vetë subjekti pranon se në pjesën hyrëse ka një lapsus, pra duhet të ishte neni 278/1/2 i Kodit Penal, dhe se në pjesën përshkruese-arsyetuese nuk citohen elementet e kësaj vepre. Në këto kushte, vlerësohet se subjekti duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në redaktimin e vendimit, që mund të ketë ardhur edhe për shkak të ngarkesës në punë, pasi siç rezultoi në vitin 2018 subjekti ka gjykuar 912 çështje. Por këto dy elemente pakujdesie, në konsideratë edhe të faktit që vendimi nuk është ankimuar nga palët, çmohet se nuk janë të tilla që të cenojnë aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit. [...].*

28.4. *Lidhur me dosjen penale të vendimit nr. ***, datë **3.2018, me të pandehur *** ***, si dhe fashikujt e procedimit penal ***/2017, nga shqyrtimi i të cilës rezulton se në datë **2.2018 është lidhur marrëveshja “Për pranimin e fajësisë nga i pandehuri *** *** në kuadër të procedimit penal nr.***, të vitit 2017”. Sipas kësaj marrëveshje rezulton më datë **10.2017 shërbimet e policisë kanë kapur në flagrancë shtetasit *** *** dhe *** *** me nga një pistoletë dhe krehër me fishekë. Ndaj shtetasit *** *** është ngritur akuza për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i K. Penal dhe i pandehuri deklaroi se e pranon fajësinë, është thellësisht i penduar, shpjegon se i kanë vrarë babain dhe nuk ka njeri tjetër të kujdeset për familjen e tij, në dhënien e dënimit me kusht do të paraqitet te Zyra e Shërbimit të Proves Lezhë. Në përfundim është arritur marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit: *I pandehuri *** *** deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak” të parashikuar nga neni 278/1 i K. Penal dhe dënimin e tij me 3 vite burgim. Në aplikim të nenit 59 të K. Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prej 4 vitesh me kusht që të mos kryej vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Lezhë. Me vendim nr. ***, datë **3.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës, miratimin e marrëveshjes së fajësisë datë **2.2018 për procedimin penal nr. ***/2017 rënë dakord me Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe të pandehurit *** ***.**

28.4.1. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”⁸⁶, nisur nga vetë përmbajtja e marrëveshjes sipas të cilës me datë **10.2017 shërbimet e policisë kanë kapur në flagrancë shtetasit *** *** dhe *** *** me nga një pistoletë dhe krehër me fishekë dhe nisur nga vendimi nr. ***, datë **9.2018, me anë të të cilit subjekti ka deklaruar fajtor të pandehurit *** *** për veprat penale të parashikuara nga neni 278/1 dhe 278/2 të Kodit Penal në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016 i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] *duket se subjekti i rivlerësimit, në miratimin e marrëveshjes së fajësisë ka vepruar jo në përputhje me kërkesën e pikës ç, të nenit 406/e/2 të K. Pr. P., pasi siç rezultoi, faktet dhe rrethanat kanë që të njëjta me atë të të pandehurit *** *** i cili është deklaruar fajtor nga vetë subjekti për veprat penale të parashikuara nga neni 278/1 dhe 278/2 të K.P, ndërkohë që ndaj *** *** është ngritur akuzë vetëm për veprën penale të parashikuar nga neni*

⁸⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqet 54-55 të vendimit.

⁸⁶ Referohuni Rezultateve të hetimit administrativ, faqe 72.

278/1 i K.P. Pra në rastin konkret cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj nuk janë vlerësuar drejtë nga prokurori, dhe ky fakt nuk është evidentuar nga subjekti [...].

28.4.2. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar⁸⁷ se marrëveshja bëhet me kërkesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, të cilët bisedojnë kushtet e pranimit të fajësisë dhe dënimit penal me prokurorin e çështjes. Sipas subjektit, kualifikimi ligjor i faktit është vlerësuar i saktë nga ana e tij, pasi fishekët e sekuestruar janë konsideruar si pjesë përbërëse të armës së zjarrit, e si të tilla mbajtja e tyre nuk përbën vepër penale më vete sipas nenit 278/2 të Kodit Penal, por fakti duhet të kualifikohej sipas akuzës së prokurorit dhe vendimit të shpallur. Ndërsa në parashtrimet shtesë të paraqitura me *email*-in datë 4.3.2024 subjekti ka sqaruar se i pandehuri *** ** rezulton se është kapur në flagrancë në datën **.10.2017 me armë zjarri pistoletë dhe krehrin e saj me 7 fishekë. Ndërsa i pandehuri *** **, përveç krehrin me 7 fishekë të armës së zjarrit që iu sekuestrua, kishte edhe një krehër tjetër rezervë me 8 fishekë, si dhe një fishek tjetër. Pra, kualifikimi ligjor i faktit nuk duhet të ishte i njëjtë për të dy të pandehurit.

28.4.3. Komisioni, ka arritur në përfundimin⁸⁸se: [...] vlerësohet se në çështjen konkrete subjekti në argumentet e veta me të drejtë i është referuar akuzës së ngritur nga prokurori, si dhe qëndron pretendimi sipas të cilit ai ka miratuar një marrëveshje që ishte nënshkruar me vullnetin e lirë të pjesëmarrësve në proces [...].

28.5. Komisioneri Publik, lidhur me tre rastet e paraqitura nga denoncuesi, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se gjetjet duhen vlerësuar, më së paku, në drejtim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr.96/2016, referuar indikatorit të aspektit të arsytimit ligjor mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit mbi rrethanat të cilat e kanë çuar në vendimmarrjet konkrete.

28.5.1. Komisioneri Publik, mban në konsideratë jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese⁸⁹, e cila thekson domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. *Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë.* Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. *Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë.*

III. B/2 - Çështje të referuara nga organet ligjzbatuese

29. *Dosja gjyqësore që përket çështjes penale me subjekt procedural shtetasin *** **, gjykuar nga gjyqtari Artan Hajredinaj, për të cilën Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, vuri në dispozicion dosjet për tri çështje penale:*

29.1. *Nga aktet e dosjes që i përket vendimit nr. ** datë **.3.2021 me objekt caktim mase sigurie, rezulton se: me kërkesë datë **.3.2021 të Prokurorisë, është kërkuar vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë si dhe caktimi i masës së sigurisë *arrest në burg*, për personin nën hetim *** **, i dyshuar për veprën penale të “Prodhim shitje të narkotikëve dhe kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga nenet 283/2⁹⁰ dhe 284⁹¹ e 25 të K. P. Me vendimin nr. ***

⁸⁷ Referohuni prapësisëme të subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale datë 24.2.2024, faqe 16-17.

⁸⁸ Referohuni arsytimit të Komisionit në faqen 54-55 të vendimit.

⁸⁹ Referohuni në vendimet nr. 3, datë 26.1.2015, nr. 63, datë 23.9.2015, nr. 24, datë 25.4.2016 dhe nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

⁹⁰ “Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

⁹¹ “Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

datë **.3.2021, subjekti ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurisë *arrest në burg me afat 20 ditë*, parashikuar nga neni 238 dhe 245 të K. Pr. P.

29.2. Nga aktet e dosjes penale që i përket vendimit nr. ** datë **.3.2021 me objekt zëvendësim mase sigurie rezulton se: shtetasi *** ** ka paraqitur kërkesë në gjykatë për zëvendësimin e masës arrest në burg dhënë me vendimit nr. **, datë **.3.2021, kërkesë e cila është regjistruar me datë **.3.2021, duke argumentuar ndër të tjera se i arrestuari është në gjendje të rëndë shëndetësore referuar akteve shkresore⁹².

29.2.1. Sipas procesverbalit datë **.3.2021, me orë fillimi 10:57, rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes ka çelur seancën për zëvendësimin e masës së sigurimit në orën 11:03:05. Në përmbajtje të këtij procesverbali thuhet se prokurori relaton argumentet, por jo se çfarë ka kërkuar konkretisht, dhe pasi është njohur me kërkesën e kërkuarit ka kërkuar të pranohet kërkesa, e në vijim në orën 11:37:46, Gjykata ka shpallur vendimin, duke pranuar kërkesën e të arrestuarit dhe ka vendosur zëvendësimin e masës *arrest në burg me atë arrest në shtëpi*.

29.2.2. Me vendimin nr. **, datë **.3.2021, subjekti i rivlerësimit, ka vendosur zëvendësimin e masës *arrest në burg me atë arrest në shtëpi*, duke arsyetuar ndër të tjera se: [...] sipas dispozitës 260/2 të K. Pr. P., për të zëvendësuar masën e sigurimit me një tjetër më të lehtë duhet të ndodhemi para njëres prej këtyre situatave: nevoja e sigurimit të jetë zbutur; masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit; masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më dënimit që mund të caktohet. Praktika gjyqësore ka pranuar se një nga rastet kur masa zbutet, është dhe për shkak të rrethanave familjare ose gjendjes shëndetësore të personit e cila duhet të jetë veçanërisht e rëndë. Në përfundim të analizës është shprehur se *duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore veçanërisht të rëndë të të arrestuarit provuar kjo me provat*, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë kushtet e parashikuara në K. Pr. P., për zëvendësimin e masës arrest në burg me atë arrest në shtëpi.

29.3. Nga aktet e dosjes penale që i përket vendimit nr. **, datë **.03.2021 me objekt zëvendësim mase sigurie, rezulton se: Prokuroria ka paraqitur kërkesë, e regjistruar në gjykatë me datë **.03.2021, për caktimin e masës së sigurisë *arrest në burg pa afat* parashikuar nga neni 238 i K.Pr.P..

29.3.1. Sipas procesverbalit të datës **.3.2021, me orë fillimi 10:57, rezulton se në orën 11:39:39 është çelur seanca, në orën 11:41:04 prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes, në orën 11:41:39, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes.

29.3.2. Sipas vendimit nr. **, datë **.3.2021, kërkesa e prokurorisë është paraqitur me datë **.3.2021. Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë rezulton se më datë **.3.2021, gjykata ka vendosur masë arrest me afat 20 ditë dhe në këto kushte në mbarim të afatit 20-ditor Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës arrest në burg. Ka rezultuar se me vendimin nr. **, datë **.3.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pranimin e kërkesës së të arrestuarit dhe zëvendësimin e masës nga arrest në burg në atë arrest në shtëpi. Nga ana e prokurorit u parashtrua se duke qenë se sipas vendimit të datës **.3.2021, gjykata ka pranuar kërkesën e të arrestuarit, kjo për shkak të gjendjes së tij të rënduar shëndetësore, kërkesa ime mbetet pa objekt dhe në këto kushte kërkoj pushimin e gjykimit. Në përfundim, gjykata ka arsyetuar se pasi gjykata më datë **.03.2021 pranoi kërkesën e të arrestuarit për zëvendësimin e masës, kjo për shkak të gjendjes së tij tejet të rënduar shëndetësore dhe kërkesa e prokurorit mbetet pa objekt dhe ka vendosur pushimin e çështjes.

⁹² Sipas shkresës dt. **.3.2021, të spitali Lezhë, rezulton se shtetasi *** ** me kartelë nr. ***/**, dt. **.3.2021 me Dg: Sindrome Koronar Acut.

- Sipas shkesës datë **.3.2021 të IEVP Lezhë, kthim përgjigje avokates, rezulton, ndër të tjera, se shtetasi *** **, më datë **.3.2021, është dërguar për vizitë të mjeku kardiolog në spitalin rajonal etj., gjendja shëndetësore nuk paraqitej e mirë dhe ka marrë mjekime dhe vazhdon mjekimin, por gjendja e tij është e paqëndrueshme shoqëruar nga sëmundjet bazike kardiake, rritja e stresit në kushtet e burgut dhe konsumi i duhanit 3 paketa në ditë.

29.3.3. Në përfundim të hetimit Komisioni, me aktin⁹³ “Rezultatet e hetimit administrativ...”, i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi duket se nga ana e subjektit të rivlerësimit, duket e pa arsyetuar dhënia e masës së sigurisë me afat 20 ditë në vendimin nr. *** datë **.3.2021.

29.3.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: [...] Arsyetimi i Gjykatës për dhënien e kësaj mase ka të bëjë me lënien kohë palëve për sigurimin e provave për të përligjur masën e sigurimit të kërkuar, dokumentacioni shëndetësor që vërtetonte problematikën shëndetësore të të arrestuarit, pretendime të cilat në vijim rezultuan të bazuara. Pikërisht në ditën e 19 të këtij afati, siç përcakton edhe ligji është paraqitur si kërkesa e prokurorit, ashtu edhe kërkesa e të pandehurit të cilat janë shqyrtuar nga Gjykata sipas kohës së paraqitjes...Vendimi i Gjykatës ka qenë i bazuar në provat e paraqitura ashtu dhe në kërkimin e vetë prokurorit, i cili është shprehur dakord për masën e sigurimit arrest në shtëpi. Neni 244/3 i K. P. Penale ka përcaktuar se gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. ..Kemi të bëjmë me vendim të dakordësuar nga të gjitha palët, ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim, pra vendim i formës së prerë për dhënien e të cilit kam gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuara në atë gjykim⁹⁴[...].

29.3.5. Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] vlerësohet se argumentet e paraqitura janë të plota dhe bindëse, pasi bazohen në dokumentet shkresore të administruara [...] ⁹⁵.

29.3.6. Komisioneri Publik, vlerëson se subjekti në arsyetimin e vendimit nr. **/2021 ka mangësi në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentit logjik në kuptim të nenit 72 pika 3 të ligjit nr.96/2016. Subjektit të rivlerësimit i mungon arsyetimi logjik dhe ka kontradiktë midis pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit. Pasi subjekti edhe pse në pjesën arsyetuese të vendimit të tij, në fq. 3- 4, argumenton se [...] Avokatja e personit nën hetim ka kërkuar një masë sigurimi më të butë se ajo e arrestit në burg duke paraqitur si argumente gjendjen shumë të rënduar shëndetësore të të arrestuarit, por që nuk paraqiti prova që të provonte pretendimet e saj në lidhje me gjendjen shëndetësore. Pretendimi i avokates së personit nën hetim *** ** për pamundësinë e caktimit të masës së sigurimit “Arrest me burg” për shkak të gjendjes veçanërisht të rëndë shëndetësore të tij dhe ndaj tij të caktohet masa e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, nuk u argumentua juridikisht me prova shkresore. Gjykata i çmon ato si shprehje standarde dhe hipotetike, në një kohë kur të dyshuari dyshohen për vepra penale me masë dënimi relativisht të lartë [...], në dispozitivin e vendimit ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktimin e një mase sigurimi më të butë duke nënkuptuar si shkak gjendjen shëndetësore të të dyshuarit.

29.3.6.1. Subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. **/2021 për caktimin e kohëzgjatjes së masës së sigurimit arrest me burg, me afat 20 ditë, pasi ka urdhëruar, sipas parashikimeve të nenit 245 pika 1, germa “d” të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka arsyetuar në vendimin e tij qëllimin e urdhërimit të kësaj mase, për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës.

29.3.7. Komisioneri Publik, gjithashtu, vlerëson se subjekti ka qenë në kushtet e bashkimit të kërkesave të regjistruara për gjykim, në frymën e përmbajtjes së dispozitës së nenit 92 të Kodit të Procedurës Penale.

29.3.8. Në këto kushte vlerësojmë se arsyetimi i vendimit nr. **, datë **.03.2021, si dhe dy vendimet e marra datë **.3.2021, të marra nga subjekti i rivlerësimit, në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, tregojnë për mangësi sipas përcaktimit të ligjit nr.96/2016, nenit 72, “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, pika 2 e tij aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, si dhe pika 3 në aspektin e cilësisë së analizës dhe e argumentit logjik, dhe duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e kriterit profesional.

30. Dosja penale që i përket vendimit nr. *** datë **.9.2021

30.1. Nga aktet e dosjes rezulton se:

⁹³ Referohuni f. 89 të aktit.

⁹⁴ Referohuni f. 25 të prapësimeve të kriterit të aftësive profesionale.

⁹⁵ Referohuni f. 65 e vendimit.

- Me kërkesë datë **.9.2021, Prokuroria ka kërkuar vleftësim arresti dhe caktim të masës së sigurimit personal për shtetasin e mitur në konflikt me ligjin *** ** të dyshuar për veprën penale “*Prodhim dhe shitja e narkotikëve*” dhe “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/1 të K. Penal. Në këtë kërkesë ndër të tjera është parashtruar se është proceduar me arrestimin në flagrancë të shtetasit *** ** dhe *** **, pasi dyshohet se në bashkëpunim me shtetasin *** ** posedojnë dhe shpërndajnë lëndë narkotike. Nga kontrolli personal i shtetasit *** ** i është gjetur pistoletë.

- Me vendim nr. **, datë **.9.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: *1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës; 2. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të arrestuarit të mitur në konflikt me ligjin *** **; 3. Të caktohet ndaj të dyshuarit në konflikt me ligjin *** ** masa e sigurimit personal “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K. Pr. Penal, pasi dyshohet për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, duke urdhëruar këtë të fundit të paraqitet pranë policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.*

- Subjekti i rivlerësimit, në këtë vendim sa i takon *** ** në lidhje me masën e sigurimit personal, ka arsyetuar se nuk rezulton se ky shtetas është i përfshirë në prodhim dhe shitja e narkotikëve dhe pretendimet e organit të Prokurorisë janë hipotetike. Për shtetasin *** ** ka prova të mjaftueshme se ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje, por jo atë të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. Lidhur me kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës arrest në burg për dy të miturit gjykata e gjen të pa bazuar në ligj dhe prova. Duke ju referuar nenit 81 të Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit i cili sanksionon se *Ndaj të miturit nuk mund të caktohet një masë sigurimi më e rëndë, nëse i njëjti qëllim mund të realizohet me një masë më të lehtë. Kur kërkohet të caktohet masë sigurimi ndaj një të mituri, prokurori në kërkesë dhe gjykata në vendim mban parasysh dhe arsyeton interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri...*

- Kundër vendimit datë nr. **, datë **.9.2021, ka bërë ankim Prokuroria duke kërkuar caktim mase sigurie atë të arrest në burg.

- Gjykata e Apelit Shkodër me vendim nr. **, datë **.9.2021 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ** datë **.09.2021, me ndryshimin: *Caktim masë sigurie për shtetasin *** ** arrest në shtëpi etj.* Gjykata e Apelit ka arsyetuar se vlerëson se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturve në konflikt me ligjin parashikuar nga neni 228 i K. Pr. P. Sipas Gjykatës së Apelit për të miturit *** ** dhe *** **, për veprat penale sipas neneve 283/2 dhe 278/1 të K.P, nuk është i supozuar por i bazuar në prova, duke cituar dhe provat.

30.2. Sa më sipër, Komisioni ka kërkuar sqarime nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me dhënien e një mase sigurimi të butë për shtetasin *** **, për të cilin Gjykata e Apelit ka vlerësuar se është në kundërshtim me provat.

30.3. Subjekti i rivlerësimit duket se i qëndron arsytimit në vendimin e tij pasi nuk dha sqarime, por ka paraqitur vendimin e dhënë prej tij dhe vendimin e Gjykatës së Apelit, administruar më parë nga Komisioni.

30.4. Komisioni, ka vlerësuar se edhe pse subjekti nuk dha ndonjë sqarim, në këtë rast, kemi të bëjmë me vlerësim të ndryshëm të rrethanave dhe provave nga subjekti pasi, siç rezultoi, vlerësimi i prokurorit nuk u gjend i bazuar nga Gjykata e Apelit, e cila ka bërë tjetër vlerësim të provave. Për rrjedhojë, nisur edhe nga natyra dhe rrethanat e çështjes, ky rast nuk vlerësohet se mban ndonjë peshë për efekt të procesit të rivlerësimit sa i përket aftësive profesionale.

30.5. *Komisioneri Publik*, ashtu siç ka arsyetuar dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin **/2021 vlerëson se masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje” që ka dhënë subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij, nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit, nevojave të sigurimit dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të vetë personave nën hetim, pavarësisht se janë të mitur.

31. Në përfundim për dy rastet e trajtuara më sipër, *Komisioneri Publik*, vlerëson se problematikat e konstatuara në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, marrin kuptim e tjetër peshë, në konsideratë dhe të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese. Ato duket se u japin besueshmëri dyshimeve të hedhura në kuptim të këtij procesi dhe afektojnë në këtë mënyrë kriterin e integritetit të subjektit të rivlerësimit, si një indikator i rëndësishëm i kriterit të aftësive profesionale. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga analiza e shkeljeve të analizuara dhe informacioneve të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, përftohen vlerësime që afektojnë indikatorët e lidhur me integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

III. B/3 - Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi dhe marrëdhëniet me shoqërinë “* ***” sh.p.k. dhe administratorin e saj, shtetetasin *** ***/ alias *** ***/**

32. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit rezulton se subjekti me shoqërinë “*** ***” sh.p.k. ka nënshkruar në emër të vëllait të tij *** ***, kontratën e sipërmarrjes nr.*** rep. nr. *** kol., datë **.121.2007, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 72 m², në Lezhë⁹⁶.

32.1. Sipas Ekstraktit historik të QKB-së, të shoqërisë “*** ***” sh.p.k, rezulton se shoqëria është regjistruar në datë *.7.1996, me administrator *** ***. Sipas akteve të depozituara në vitin 2005, shtetasi *** ***/ është bërë ortak në këtë shoqëri dhe njëkohësisht është caktuar në cilësinë e administratorit, cilësi në të cilën ka qenë edhe në vitin 2007 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes nga subjekti i rivlerësimit. Nga ndryshimi i të dhënave të regjistruara në QKB, në datë **.12.2014, rezulton se në vitin 2014, ortaku *** ***/ ka ndryshuar emrin në *** ***/.

32.2. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë⁹⁷, dosjet për 3 çështje të trajtuara nga subjekti ku palë në gjykim është shoqëria “*** ***” sh.p.k., si dhe shtetasi *** ***/.

32.3. Subjekti i rivlerësimit, Artan Hajredinaj **ka gjykuar çështjen që i përket vendimit nr. *****, datë **.4.2022 me palë paditës *** ***/, i paditur shoqëria “***-***” sh.p.k., me objekt lirim dorëzim sendi, ku është vendosur pushimi i çështjes. Nga përmbajtja e vendimit vërehet se në datë **.4.2022, gjykata, pasi ka verifikuar se palët kanë dijeni për zhvillimin e seancës, pala e paditur është njoftuar me shpallje, nuk janë paraqitur për ndonjë shkak të arsyeshëm, në bazë të nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur pushimin e çështjes. Gjithashtu, ka arsyetuar dhe faktin se avokati i palës paditëse, pas disponimit të gjykatës për pushimin e çështjes, në orën 10:52 ka depozituar në kryesekretari kërkesë për shtyrje seance për shkak se i duhej të ndiqte një tjetër çështje në Gjykatën e Durrësit, por nuk ka bashkangjitur asnjë akt përfaqësimi.

32.4. Subjekti i rivlerësimit, Artan Hajredinaj është shortuar për të gjykuar **çështjen civile nr. akti *****, datë **.1.2023 (që daton e regjistruar më vonë se çështja më sipër) **me palë shoqëria “***-***” shpk dhe shoqëria “***” sh.p.k.**, me objekt sigurim padie dhe zgjidhje kontrate.

32.4.1. Subjekti i rivlerësimit me kërkesë nr. *** regj. them. datë **.1.2023 ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendim datë **.1.2023 ka vendosur miratimin e kërkesës së gjyqtarit Artan Hajredinaj, dhe nga rishortimi i ka kaluar një gjyqtari tjetër.

32.4.2. Nga përmbajtja e vendimit datë **.1.2023 të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka pranuar kërkesën e subjektit, vërehet se subjekti ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes duke parashtruar si shkak faktin se ai në datën **.12.2007 ka nënshkruar kontratë sipërmarrje nr. ***/***/ tek noteri *** ***/, për llogari të vëllait të tij *** ***/ i cili në atë kohë ndodhej në Angli etj., duke bërë shënimin se apartamenti porositet nga *** ***/ i cili do të nënshkruajë kontratën përfundimtare, kontratë e cila është lidhur me datë **.01.2019. Gjithashtu, subjekti

⁹⁶ Trajtuar gjerësisht në pikën 17 të këtij ankimi.

⁹⁷ Me shkresë nr. ***/**/ prot., datë **.9.2023, të GJSHPJP Lezhë.

ka deklaruar se ai dhe vëllai nuk kanë ndonjë marrëdhënie interesi me shtetasin në fjalë, por duke qenë në të tilla kushte në bazë të nenit 73 të K. Pr. C. ka pengesa ligjore për gjykimin e kësaj çështje.

32.5. Komisioni lidhur me shtetasin ** *** **dhe** *** *** *** (i njëjti person) ka administruar tre çështje penale si vijojnë:

32.5.1. Subjekti ka dhënë **Vendimin nr. *** datë **.5.2019** me objekt “Miratimin e arrestit provizor dhe caktim masë sigurimi” për shtetasin *** *** *alias* *** ***. Paraprakisht, me kërkesën datë **.5.2019 subjekti i rivlerësimit Artan Hajredinaj, ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin datë **.5.2019 ka vendosur mospranimin e heqjes dore nga gjykimi i çështjes penale. Nga përmbajtja e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, vërehet se subjekti ka parashtruar të njëjtat shkaqe si në rastin e çështjes më sipërcituar, ndërsa kryetarja e gjykatës, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë duke arsyetuar ndër të tjera se në thelb se nuk ka marrëdhënie kontraktore ndërmjet gjyqtarit dhe shtetasit *** *** *alias* *** ***, por vetëm që ka pasur ndërmjet vëllait të gjyqtarit dhe personit juridik “***-***” shpk dhe kjo shoqëri tashmë ka përfaqësues shtetasin *** *** dhe jo shtetasin *** *** *alias* *** ***.

32.5.2. Sa i takon vendimit nr. *** datë **.5.2019 të dhënë nga subjekti për miratimin e arrestit provizor dhe caktim masë sigurimi për shtetasin *** *** *alias* *** ***, vërehet se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar miratimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë *arrest në burg me afat 40 ditor*. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë fillimisht ka kërkuar miratimin e arrestit dhe caktimin e *masës së sigurisë arrest në burg me afat 40 ditor*, ndërsa në seancën gjyqësore prokurori ka kërkuar *masën e arrestit në shtëpi* për shkak të gjendjes shëndetësore të të arrestuarit. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se duke pasur në konsideratë gjendjen jo të mirë shëndetësore sipas provave në dosje, duhet pranuar kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në vijim subjekti i rivlerësimit ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit me qëllim ekstradimit, dhe caktimin e *arrestit në shtëpi me afat 40 ditë*.

32.5.3. Me **vendimin nr. ** datë **.4.2020** me objekt zëvendësim mase sigurimi, subjekti i rivlerësimit nuk e ka pranuar kërkesën e *** *** *alias* *** ***, për zëvendësimin e masës arrest në shtëpi me një mase më të butë.

32.5.4. Subjekti i rivlerësimit me **vendimin nr. **, datë **.9.2020** me objekt “Lejim ekstradimi” të *** *** *alias* *** ***, ka refuzuar lejimin e ekstradimit të tij, duke arsyetuar se bazuar në nenin 491/f të K. Pr. P., për gjykatën mosdhënia e garancisë për rishikimin e vendimit (të dhënë në mungesë të të pandehurit) nga shteti kërkuar, përbën pengesë të pakapërcyeshme për lejimin e ekstradimit.

32.5.5. Nga vlerësimi i këtyre rasteve Komisioni ka konstatuar se në lidhje me **çështjen që i përket vendimit nr. *** datë **.4.2022** me palë paditës *** ***, i paditur shoqëria “***-***” sh.p.k., është e paqartë përse subjekti nuk ka kërkuar dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështje, ashtu siç ka vepruar në çështjet e tjera, *fakt për të cilin në rezultatet e hetimit i ka kërkuar subjektit të japë sqarime* duke vërtetuar që nuk është në kushtet e pengesës ligjore sipas nenit 73 të K. Pr. C.⁹⁸.

32.6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: [...] *Lidhur me mungesën e heqjes dorë në këtë rast, ... kjo çështje është regjistruar në vitin 2021. Ndërkohë, tashmë kishte një praktikë (vendim gjyqësor) për konstatimin e mosekzistencës së shkaqeve për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes penale me palë ***. ***, pasi në vitin 2019 kërkesa për heqje dorë nuk ishte pranuar nga gjykata. Për këtë arsye, kam vlerësuar se paraqitja e një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, me palë paditëse *** ***, i paditur shoqëria “***-***” sh.p.k., për shkak të nënshkrimit të një kontrate sipërmarrjeje në vitin 2007, do të konsiderohej sërish si i pabazuar nga gjykata. Ndërsa kërkesën e tij për heqje*

⁹⁸ Referohuni f. 92 të rezultateve të hetimit.

dorë nga gjykimi i çështjes civile, me nr. akti ***, datë **.1.2023, Gjykata e Apelit Shkodër e ka vlerësuar si të bazuar⁹⁹ [...].

32.7. Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] Sqarimet e subjektit janë të plota dhe bindëse. Siç ka rezultuar, subjekti që në vitin 2019, në kërkesën e tij për heqje dorë në shqyrtimin e një çështjeje penale me palë shtetasin ***, ***, ka parashtruar si shkak pikërisht faktin se ai në datën **.12.2007 ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje për llogari të vëllait të tij ***, ***, ku shtetasi ***, ***. ka qenë përfaqësues i shoqërisë “***-***” sh.p.k. dhe kjo kërkesë nuk është pranuar nga kryetarja e gjykatës. Përpos kësaj, përveç faktit që marrëdhënia e subjektit me shoqërinë ka qenë përpara rreth 15 viteve, si dhe në rastin konkret nuk është zgjidhur çështja në themel [...] ¹⁰⁰.

32.8. Komisioneri Publik, ndryshe nga arsyetimi i Komisionit, vlerëson se, subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit faktit të interesit, duke mos paraqitur kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile me palë paditës ***, ***, i paditur shoqëria “***-***” shpk, në referencë të nenit 72-73 të K. Pr. Civile. Arsyetimi i Komisionit se çështja e mësipërme nuk ka qenë çështje themeli që duhej të jepte dorëheqjen, nuk gjendet i bazuar në ligj, pasi nuk përjashtohet ligjërisht asnjë çështje, qoftë kjo e konfliktit të kompetencave, që të justifikojë qenien e gjyqtarit në vendimmarrjen e këtyre çështjeve gjyqësore, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo situatë faktike e pohuar edhe pranuar edhe nga vetë subjekti së paku në 2 raste të tjera: (i) në gjykimin për masën e sigurimit të shtetasit *** ***, alias *** ***, përfunduar me Vendimin nr. *** datë **.5.2019, si dhe (ii) në çështjen civile nr. akti *** datë **.01.2023 me palë shoqëria “***-***” sh.p.k. dhe shoqëria “***” sh.p.k. me objekt sigurim padie, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, e vë subjektin në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, pasi subjekti nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërhyrëse ishte një shoqëri me të cilën ka pasur marrëdhënie juridiko-civile, apo angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005 dhe përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm.

32.9. Komisioneri Publik, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit apo atij në dukje, duhej të hiqte dorë nga çështja që i përket vendimit nr. *** datë **.4.2022 me palë paditës ***, ***, i paditur shoqëria “***-***” sh.p.k. Subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e heqjes dorë, me qëllim shmangien e çdo dyshimi për paanësinë e tij, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, që çon në një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë, sipas përcaktimeve të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, dhe nga një vlerësim tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

32.10. Mangësi të njëjta e të përsëritura konstatohen edhe në çështjen gjyqësore për të cilën subjekti ka dhënë vendimin nr.**, datë **.2.2021, denoncimi i shtetasit ***, ***, si dhe në çështjen gjyqësore për të cilën subjekti ka dhënë vendimin nr.***, datë **.12.2014, denoncim¹⁰¹ i shtetasit ***, ***, etj.

33. Komisioneri Publik, duke përfunduar për sa i përket kontrollit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës e provës. Mangësitë e vërejtura në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, të verifikuara nisur nga denoncimet e paraqitura nga publiku janë të natyrës vazhduese dhe të njëjta, duke përbërë në këtë mënyrë tregues të një modeli pune.

34. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në këto rrethana veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 72, pika 2 dhe 3, dhe nenin 75, pika 3, të ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara më sipër duhen trajtuar nga Kolegji eventalisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të

⁹⁹ Referohuni faqe 36-37 të prapësimeve të kriterit të aftësive profesionale.

¹⁰⁰ Referohuni f. 66 të vendimit të Komisionit.

¹⁰¹ Shihni denoncimin nr. 3984 prot., datë 7.5.2018.

ankimit, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

35. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

36. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

37. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

38. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016;

39. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 744, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA